



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 203

Tiranë – E mërkurë, 2 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 12.10.2016	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Peshkimit 2016–2021..... 21933

**VENDIM****Nr. 701, datë 12.10.2016****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE TË PESHKIMIT 2016–2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Peshkimit 2016–2021, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet e Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



STRATEGJIA KOMBËTARE E PESHKIMIT 2016-2021

PARATHËNIE

Ky dokument paraqet Strategjinë Kombëtare për Peshkimin (SKP) për sektorët e peshkimit dhe akuakulturës në Shqipëri nga 2017 deri në 2022. Strategjia u përgatit nga MBZHRAU në vijim të një vlerësimi të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, i cili u realizua në fund të vitit 2015 (Particip dhe Poseidon, me mbështetje të Bashkimit Europian). Analiza e situatës aktuale në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, që paraqitet në këtë strategji, reflekton gjetjet dhe analizën e detajuar që përmban Raporti i Vlerësimit (RV).

Qëllimi i strategjisë është prezantimi i një vizioni të përgjithshëm strategjik për zhvillimin afatmesëm të sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës. Ajo përcakton objektivat dhe prioritetet e Shqipërisë, të cilat janë në përputhje me ato të Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE.

Një strategji e planifikuar me kujdes, e cila zbatohet përmes një plani veprimi, është me rëndësi madhore për përmirësimin e kontributit social dhe ekonomik të sektorit të peshkimit.

Në interes të harmonizimit të politikës dhe administrimit me *Acquis* të peshkimit dhe PPP, ky dokument planifikimi strategjik udhëhiqet nga legjislacioni përkatës i politikave të BE për peshkimin, në mënyrë specifike Rregullorja (BE) 1380/2013¹ (Politika e Përbashkët e Peshkimit).

¹ Rregullorja (BE) Nr 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Common Fisheries Policy)



Kapitulli 1. KUSHTET AKTUALE

1.1 Rëndësia e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës në Shqipëri

Pavarësisht se sektori i peshkimit jep një kontribut relativisht të ulët në ekonominë shqiptare, në kuadër të kontributit në PBB dhe punësimit në përgjithësi, ai është i rëndësishëm nga pikëpamja social-ekonomike në komunitetet bregdetare dhe në ujërat e brendshme ku ai siguron punësim në ato zona të vendit me mundësi të pakta punësimi dhe kostot e ulëta të krahut të punës.

Statistikat zyrtare dhe vlerësimet duket se paraqesin të zvogëluar prodhimin aktual, ndërkohë që nuk ka të dhëna të fundit mbi shtrirjen e peshkimit IUU (Illegal, Unreported Unregulated). Vlerësohet se zëniet e paraportuara janë të paktën 30% e vlerës së zënieve në peshkimin detar të raportuar. Nisur nga madhësia e peshkimit IUU dhe akuakulturës në një masë më të ulët, ka gjasa që kontributi i plotë nga peshkimi dhe akuakultura të jetë konsiderueshëm më i lartë sesa vlerësimi, veçanërisht kur përfshihen edhe aktivitetet ekonomike të zinxhirit, siç janë përpunimi i peshkut, riparimi dhe mirëmbajtja e anijeve, tregtimi, transporti, magazinimi dhe shërbimet mbështetëse.

1.2 Politika aktuale e peshkimit dhe objektivat e zhvillimit kombëtar

Aktualisht nuk ka një kuadër apo dokument të vetëm që të adresojë politikën dhe planifikimin e nevojave për sektorin. Kjo Strategji do të mbulojë këtë boshllëk.

Kohët e fundit, MBZHRAU ka përgatitur një strategji ndër-sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri (MBZHRAU, 2014). Ky dokument artikulon disa sfida, mundësi dhe prioritetet për sektorin, por nuk përmendet sektori i peshkimit.

Kështu që, sektori mbetet pa një politikë koherente apo një plan strategjik. Referenca e vetme për ndonjë mjet të politikës dhe planifikimit të peshkimit është në ligjin aktual për peshkimin, ku referohet se "Politikat e peshkimit në Republikën e Shqipërisë hartohen dhe zbatohen në përputhje me strategjinë kombëtare të peshkimit, planin e menaxhimit të peshkimit dhe planin e zbatimit të peshkimit" (Neni 23).

1.3 Çështje të zhvillimit

Që në vitin 1995 Shqipëria ka përfutur nga një sërë burimesh të jashtme financimi dhe projekte zhvillimi që lidhen me sektorin.

Normat e interesit janë mjaft të larta dhe frenuese për sektorin e peshkimit, sidomos me normat e ulëta të kthimit të investimit dhe fitimit të ulët që vërehet në flotën detare. Sigurimi i kolateralit është një shqetësim shtesë për marrjen e kredive tregtare, pasi anija si aset i shumicës së peshkatarëve, është kaq e vjetër sa është amortizuar në zero. Kështu që zhvillimi dhe modernizimi i peshkimit

detar dhe në ujërat e brendshme do të kërkojë edhe investime direkt dhe akses tek kreditë, përveç trajnimit, përmirësimit të kontrollit dhe menaxhimit.

Potenciali për diversifikim

Tashmë ka praktika për diversifikimin e flotës, pasi disa anije i ndërrojnë mjetet e peshkimit. Speciet e pelagjikeve të vegjël janë një mundësi për shfrytëzim, dhe që zhvendosin sforcon prej sektorit të tratave koçeve. Gjithashtu ato sigurojnë lëndën e parë për sektorin e përpunimit në Shqipëri, duke ulur kështu varësinë nga importet.

Aktivitetet e mundshme diversifikimi përfshijnë përdorimin e anijeve për monitorim dhe kërkim shkencor për peshkimin (duke supozuar që ka financim të mjaftueshëm për këtë të fundit); mbrojtjen e burimeve peshkore (siç bëhet tashmë në Liqenin e Shkodrës); sigurinë dhe shpëtimin në det dhe ekoturizmin (peshkim çlodhës, argëtues dhe zhytje).

Për sa i përket peshkimit në liqene, duhet theksuar se peshkimi IUU shpesh nxitet nga mungesa e diversifikimit të mundësive për gjenerimin e të ardhurave në komunitetet rurale, kështu që ky problem duhet adresuar përmes kombinimit të ndërgjegjësimit me reformën ekonomike.



Forcimi institucional dhe edukimi

Forcimi institucional në mbështetje të përmirësimit të kontrollit të sektorit dhe ngritja e kapacitetit të administratës publike, konsiderohen si prioritetet më të larta për zhvillimin e sektorit në të ardhmen. Nëse ripërtërihet dhe forcohet sistemi i OMP-ve, atëherë do të bëhen, së bashku me sektorin publik, bashkëmenaxhuese të rezervave peshkore të vendit. Zbatimi efektiv i një regjimi bashkëmenaxhimi përfshin një nevojë të konsiderueshme të rritjes së kapaciteteve të personelit të peshkimit në MBZHRAU dhe të OMP-ve.

Për personelin e MBZHRAU që punon në sektor, përfshirë inspektorët, duhet të përgatitet një Vlerësim i detajuar i Nevojave për Trajnim dhe një Plan i detajuar Trajnimi; këto çështje janë adresuar në këtë strategji me një plan të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore (ZHBNJ).

I vetmi institucion i arsimit të lartë për peshkimin dhe akuakulturën është Universiteti Bujqësor i Tiranës, i cili administron edhe Laboratorin e Peshkimit dhe Akuakulturës në Durrës.

Kërkimi shkencor

Ndërkohë që në Shqipëri ka një trashëgimi të fortë akademike, për momentin po bëhet shumë pak në kërkim shkencor detar. Ato pak programe mësimore që ekzistojnë nuk janë të fokusuara tek karriera, pasi për shumë vite nuk ka pasur ndonjë drejtim të qartë të karrierës në kërkimin shkencor detar.

Si hap i parë mund të ishte zbatimi i një sistemi të detajuar të mbledhjes së të dhënave për të mbështetur menaxhimin e sektorit, si dhe përpjekjet rajonale për kërkime shkencore. Kohët e fundit kjo gjë është mbështetur *ad hoc* nga projektet e AdriaMed, por duhet të përfshihet në zërat e buxhetit të MBZHRAU.

Zhvillimi i mbledhjes së të dhënave dhe kërkimi shkencor, të adresuara në strategji, duhet të bazohen në një vlerësim tërësor të nevojave duke kombinuar nevojat për menaxhim me angazhimet shkencore rajonale.

Dihet relativisht pak për ekologjinë dhe funksionimin e ekosistemeve që lidhen me peshkimin në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme. Ndërkohë që përmasat e vogla të këtij peshkimi nuk kërkojnë programe kërkimore të mëdha dhe të kushtueshme, ka nevojë për një plan kërkimor periodik dhe të prioritar, i cili do të mbulojë secilën prej këtyre kategorive ujore, individualisht.

Zhvillimi rajonal dhe bashkëpunimi ndërkufitar

Zhvillimi rajonal mund të forcohet përmes bashkëpunimit ndër-rajonal me vendet fqinjë, përfshirë Greqinë, Italinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kosovën. Ka parashikime për zhvillimin rajonal në të ardhmen, ku Asistenca e Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA I) njuh nevojën për bashkëpunim ndërkufitar në disa sektorë, përfshirë mjedisin dhe ndryshimet klimatike, politikat bujqësore, tregtinë dhe transportin rajonal.

Mbrojtja e mjedisit

Prodhimtaria e peshkimit dhe akuakulturës varet shumë nga një ekosistem i shëndetshëm dhe që funksionon mirë. Si i tillë, sistemi është i prekshëm nga vetë aktivitetet e tij siç janë mbipeshkimi, ndikimi në habitate dhe shkarkimi i gazrave dhe lëngjeve, si dhe nga aktivitetet e sektorëve të tjerë, siç janë rrjedhat dhe cilësia e ujërave nëntokësore, ndotja dhe ndërtime të paplanifikuara.

Peshkimi çlodhës argëtues

Peshkimi çlodhës argëtues përfaqëson një mundësi të madhe zhvillimi dhe potencialisht me vlerë të lartë, sidomos e kombinuar me ekoturizmin. Perspektivat e zhvillimit përfshijnë ujërat detarë dhe bregdetarë, liqenet, lumenjtë dhe rezervuarët. Ky nën-sektor i peshkimit përfiton tashmë një nivel të caktuar rregullimi përmes legjislacionit për peshkimin, megjithëse është e qartë se kjo gjë duhet administruar për të maksimalizuar përfitimet ekonomike dhe sociale.



1.4 Kuadri ligjor, administrativ dhe institucional

Kuadri ligjor

MBZHRAU është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit 'Për Peshkimin' (Ligji Nr. 64 datë 31.05.2012 i ndryshuar me Ligjin Nr. 129 datë 27.12.2012 dhe Ligjin Nr. 29 datë 24.02.2013). Objektivi i këtij ligji është menaxhimi i aktivitetit të peshkimit dhe mbrojtja e resurseve të specieve detare dhe të ujërave të brendshme, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të aktiviteteve të peshkimit.

Është miratuar së fundmi ligji 'Për Akuakulturën' i cili nuk ka hyrë akoma në fuqi. Tashme është në fazën finale të miratimit të tij në Kuvend.

Aktualisht janë në fuqi katër Vendime kyç të Këshillit të Ministrave që lidhen me sektorin e peshkimit detar dhe një sërë VKM-sh që aplikohen në sektorin e peshkimit në ujërat e brendshme, si dhe një rregullore kyç për zbatim. Hollësi të mëtejshme mbi përputhjen me legjislacionin e BE-së për peshkimin, mund të gjenden në analizën e boshllëkut ligjor, të hartuar në Raportin e Vlerësimit.

Kuadri administrativ dhe institucional

Drejtimi i sektorit të peshkimit ka një histori të ndërlikuar përgjatë 10 viteve të fundit, me disa ndryshime të 'shtëpisë' institucionale të administratës së sektorit, nisur nga viti 2005. Drejtimi jo-efektiv i sektorit dhe mungesa e stafit të nevojshëm dhe të trajnuar mbetet dobësia më serioze brenda sektorit dhe reforma institucionale konsiderohet si prioriteti më i lartë që administrata e re duhet të adresojë përmes kësaj strategjie.

Pas zgjedhjeve në vitin 2013 administrata e sektorit, së bashku me shërbimin e inspektimit të peshkimit, kaloi nga MMPAU duke u kthyer pas tek Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Megjithatë, përveç pak specialistëve të dedikuar të sektorit që punojnë në administratën drejtuese, nuk ka një strukturë koherente të administratës së peshkimit, që prej fundit të vitit 2012.

Një dobësi tjetër institucionale serioze brenda sektorit është se nuk ka kapacitet për detyrimin për zbatimin e ligjit. Një grup prej 22 inspektorësh, nën Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (pra jashtë kuadrit kryesor institucional të MBZHRAU) vepron vetëm si monitorues (mbledhës të dhënash) dhe inspektorët janë të shpërndarë në mënyrë jo-proporcionale në gjithë vendin (fare pak prej tyre veprojnë në bregdet) dhe nuk ka mjaftueshëm që të garantojnë një mbulim të mjaftueshëm.

Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP-të) u themeluan nga një projekt i Bankës Botërore, duke filluar nga 2002, për të: (a) marrë përgjegjësinë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e porteve dhe qendrave të përmirësuar të peshkimit (të cilat ju transferuan OMP-ve), dhe (b) për të marrë pjesë në bashkëmenaxhimin² e burimeve peshkore në partneritet me administratën e peshkimit. Në thelb OMP-të janë organe publike me bazë në komunitet³ që funksionojnë mbi baza jo-fitimprurëse.

Nga 13 OMP-të e themeluara vetëm 5 mbeten aktive. Më aktivet janë ato të liqeneve, përfshirë OMP-në e Shkodrës dhe të Pogradecit. Kjo strategji përfshin një aktivitet që kërkon të adresojë më me hollësi shkaqet për kapacitetin dhe veprimtarinë e kufizuar të OMP-ve, dhe rolin e tyre në administrimin e sektorit në të ardhmen.

1.5 Peshkimi detar dhe bregdetar

Rezervat

² Bashkëmenaxhimi është ndarja e përgjegjësisë dhe/ose autoritetit mes Shtetit dhe përdoruesve lokalë të burimeve, për të përmirësuar menaxhimin e burimeve të peshkimit.

³ Përcaktohen si organ i pavarur privat me personalitet ligjor, në përputhje me parashikimet e Nenit 26 të Kodit Civil, për të ndërmarrë veprime në sektorin e peshkimit, bazuar në parashikimet e këtij ligji.



Statistikat zyrtare tregojnë se ka pasur një ripërtëritje në sasinë e zënë dhe të zbarkuar, me mbi 3,000 ton. Nuk disponohen të dhëna zyrtare mbi vlerën, por vlera e llogaritur e sasisë së peshkut të zënë për peshkimin detar dhe bregdetar është rreth 17 milionë EURO. Saktësia e këtyre të dhënave është me pikëpyetje, pasi vlerësimi i prodhimit tregon se më shumë se 30% e zënieve nuk raportohen.

Merluci, barbuni, vopa, stavridi, cefalopodët e ndryshëm, karkaleci etj janë specie të rëndësishme dhe me vlera të larta dhe peshkimi i disa specieve pelagjike (sardeles dhe acuges) ka natyrë sezonale, por shumica e ndryshimeve sezonale në sasinë e peshkut të zënë preken nga ndryshimet e sforcos po aq sa dhe nga ndryshimet sezonale të peshkimit.

Flota

Të dhënat e fundit nga regjistri i flotës tregojnë se janë 553 anije peshkimi të licencuara. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (GSA) 18 (Adriatiku i Jugut) dhe përbën vetëm një pjesë të vogël të anijeve aktive në Adriatik, duke u llogaritur në më pak se 8% e trata koçeve (në numër).

Mosha mesatare shumë e lartë e flotës që llogaritet në 40 vjeçare, krahasuar me mesataren e BE-së prej 21 vjeçare, nënkupton se ka nevojë për mirëmbajtje vjetore dhe ripërtëritje të rregullt të anijeve. Megjithatë, gjendja e dobët e shumë anijeve tregon se ka një ri-investim të pamjaftueshëm për riparimin dhe mirëmbajtjen.

Menaxhimi

Rezervat peshkore në ujërat shqiptare janë rezerva të përbashkëta të Adriatikut, kështu që është më e përshtatshme që vlerësimi i rezervës të bëhet përmes bashkëpunimit rajonal. Universiteti dhe sektori i OJQ-ve/privat kanë marrë përgjegjësi të ndryshme për mbledhjen e të dhënave dhe janë angazhuar në kerkimin shkencor të peshkimit në rajon, përmes GFCM. Megjithatë, aftësia për të shërbyer kundrejt këtyre përgjegjësive pengohet nga një buxhet shumë i kufizuar, i cili është pothuajse tërësisht i varur nga mbështetjet *ad hoc* me projekte. Gjithashtu ka disa boshllëqe serioze në kapacitetet institucionale për kryerjen e shërbimeve të kërkimit shkencor dhe vlerësimit të rezervës.

Një zhvillim pozitiv në Shqipëri është krijimi i regjistrit kombëtar të flotës, i cili u realizua, së bashku me trajnimin, nga FAO (GFCM). Megjithëse nuk është në të njëjtin nivel si regjistri i flotës në BE, përsëri siguron të dhëna të detajuara deri në një nivel të pranueshëm. Shqetësimi kryesor është kapaciteti i kufizuar brenda ministrisë për ta mbajtur regjistrin të përditësuar.

MKV e flotës peshkimit, tashmë është përgjegjësi e Qendrës Ndër-Institucionale të Operacionale Detare (QNOD), që gjendet në Durrës, e cila koordinon detyrat e patrullimit detar. Shtrirja e zbatimit të ligjit në porte dhe në det mbetet e kufizuar.

Infrastruktura

Katër portet e peshkimit kanë mungesë të menaxhimit efektiv dhe janë në një gjendje gjithnjë e më të keqe, gjë që është adresuar vetëm në Durrës me ndërtimin mjaft të vonuar të portit të ri të peshkimit.

Në Shqipëri nuk ka shkallë apo struktura funksionale të riparimit. Anijet riparohen në Itali, Greqi gjë që sjell kosto shtesë për flotën detare, të vlerësuara në afërsisht gjysmë milionë euro dhe një humbje të aktivitetit ekonomik për vendin pasi një vlerë e llogaritur në €4.3 milionë në vit shpenzohet nga flota aktive për riparime jashtë vendit⁴.

Sigurimi i akullit dhe magazinimit të ftohtë është i kufizuar dhe shpesh bëhet nga firmat e shitjes me shumicë, sipas kushteve të shitjes së prodhimit. Infrastruktura e kufizuar e tregut në porte ndikon negativisht në çmimet e dorës së parë si dhe tek higjiena dhe cilësia.

⁴ Këto llogaritje supozojnë se çdo anije mbi 12m kryen çdo vit një javë riparime në Itali, gjë që sjell kosto shtesë (bazuar në €3,000 në javë kosto ekuipazhi dhe kostot shtesë të naftës për çdo ditë udhëtim në të dy drejtimet. Për flotën aktuale aktive kjo vlerë shkon në €489,000. Nëse merren në konsideratë të gjitha anijet mbi 12m të licencuara, këto kosto shtesë rriten në €813,000. €4.3 milionë si shpenzime vjetore të flotës për riparime është llogaritur bazuar në 143 anije aktive mbi 12m me një shpenzim mesatar prej €30,000.



1.6 Peshkimi në lagunat bregdetare dhe në ujërat e brendshme

Mjedisi

Mjedisi bregdetar: Në Shqipëri ka tetë laguna bregdetare, të cilat mbështetin peshkimin tregtar, dhe shtrihen nga Butrinti në kufirin me Greqinë në jug deri në Velipojë në kufirin me Malin e Zi në veri, me një sipërfaqe totale prej 10,635 hektarë.

Laguna e Butrintit është unike në faktin se është e thellë, e rrethuar në masën më të madhe nga masive të pjerrëta shkëmbore dhe ka një mjedisi të qëndrueshëm fizik. Në krahun tjetër, shumica e lagunave në Shqipëri janë shumë të cekëta dhe subjekt i ndryshimeve sezonale në derdhjen e ujërave të ëmbla, temperaturës së ujit, niveleve të larta të avullimit, ndërsa shkëmbimi i ujit me detin gjatë baticave kontrollohet përmes kanaleve të komunikimit me detin, të cilat vuajnë nga depozitimet dhe bllokimet e papritura. Lagunat përbëjnë strehime të rëndësishme për jetën e egër dhe kafshët, dhe dy prej tyre (Butrinti dhe Karavastaja) janë të njohura globalisht si zona Ramsar dhe njëkohësisht janë shpallur parqe kombëtare.

Lagunat bregdetare përfaqësojnë ekosistemet bregdetare më të ndjeshme dhe më të rëndësishme të Shqipërisë. Ato janë zona me vlera dhe përdorime të shumfishta ekologjike dhe ekonomike duke:

- siguruar habitate për peshqit, shpendët dhe kafshët e tjera;
- mbështetur rrjete komplekse të ushqimit;
- absorbuar ujin për të reduktuar përmbytjet dhe dëmtimet nga stuhitë;
- siguruar kontrollin e erozionit;
- përmirësuar cilësinë e ujit; dhe
- siguruar hapësira me vlera të mëdha estetike natyrore.

Më gjithë rëndësinë e tyre ekologjike, rreth 50% e sipërfaqes së lagunave ka humbur nga bonifikimi dhe mbushjeve që prej 1950, ndërkohë që zhvillimi bujqësor, urban dhe industrial përreth tyre e kërcënon më tej cilësinë dhe natyrën e rrjedhave ujore në këto ligatina unike.

Lagunat bregdetare: Këto laguna mbështetin një peshkim të vogël por të rëndësishëm në nivel lokal, duke prodhuar rreth 300 mt peshk në vit, me një rendiment mesatar prej 36 kg/ha, i cili është shumë më pak se gjysma e atij të vitit 1990.

Prodhimtaria e pakësuar ka mundësi që të vijë si rezultat i ndryshimeve të regjimeve hidraulike, për shkak të menaxhimit të dobët dhe ndryshimeve të përdorimit të tokës përreth, si dhe për shkak të mbi-peshkimit. Kjo demonstron nga rënia e Zënies për Njësi të Sforcos (CPUE), nga 5.6 mt për person të licencuar në vit në Karavasta në 2002, në 1.7 mt në 2013.

Zënie komerciale dominohen nga specie me vlera të larta siç janë ngjala, koca, levreku dhe specie të ndryshme të qefullit. Një shenjë e mundshme e degradimit të habitatit është rritja e pranisë dhe e zënive të gaforres blu, e cila besohet se është një specie pushtuese (*Portunus segnis*) nga Deti i Kuq.

Laguna e Butrintit në jug është një përjashtim, pasi prodhimi natyror plotësohet nga akuakultura, në formën e rritjes së midhjes. Aktualisht ka 26 rritës të midhjes me licencë, që prodhojnë rreth 2,000 mt.

Ujërat e brendshme:

Tre liqenet më të mëdhenj në Shqipëri janë Liqeni Shkodres, Ohrit, Prespa Madhe dhe e Vogël. Secili prej dy liqeneve më të mëdhenj ka një sipërfaqe totale prej rreth 260 km², ndërsa Prespa e Vogël është gati sa 1/5 e kësaj vlere..

Liqeni i Shkodrës është një liqen i madh dhe i cekët, ku peshkohet rreth 1,100 ton peshk, nga të cilat 32% janë skortë, 31% krap dhe 16% gjuhçë dhe karas secila, me sasi më të vogla të qefullit dhe ngjalës.



Liqeni i Ohrit (i varfër me ushqyes) është i famshëm për faunën e tij endemike të peshkut, përfshirë koranin (*Salmo letnica*) dhe belushkën (*S. ohridanus*). Historikisht është bërë edhe ripopullimi me rasat korani e krapit.

Liqenet e ndërlidhur të **Prespës** kanë një përzierje prej 11 specieve indigjene dhe të prezantuara, nga të cilat shumica i përket familjes së krapit. Peshqit e Prespës siç është cironka, janë me vlerë relativisht të ulët në treg, krahasuar me ata të Liqenit të Ohrit. Specie të tjera endemike përfshijnë troftën e Prespës (*S. peristericus*), sharmakun dhe ngjalën, si dhe specie si mustaku, çeliku dhe mërena.

Menaxhimi i rezervës

Kontrolli në lagunat bregdetare: Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP-të) po veprojnë për disa vite në laguna, por sidoqoftë, përfshirja e tyre në menaxhimin e peshkimit në veçanti dhe në menaxhimin më të gjerë të lagunave, është e kufizuar. Edhe përfshirja e administratës në menaxhimin e peshkimit në laguna ka dobësitë e veta, që lidhen me njohuritë e pakta për kapacitetin mbajtës të lagunave, aftësinë e kufizuar për të kontrolluar sforcën e peshkimit dhe mungesën e menaxhimit të bazuar në ekosistem.

Kontrolli në ujërat e brendshme: Liqenet natyrore si dhe rezervuarët artificialë në Fier, Elbasan, Ulëz dhe Shijak kanë OMP-të e tyre, që në vitin 2002. Sikurse lagunat bregdetare, edhe ujërat e brendshme vuajnë nga kapaciteti i ulët institucional i administratës së peshkimit, me një bashkëmenaxhim të ulët për të mbështetur OMP-të dhe me një nivel të lartë të peshkimit IUU. Menaxhimi dobësohet më tej për shkak të mungesës së një politike për të garantuar që sforcja e peshkimit të mbetet brenda kufijve biologjikë, si dhe për shkak të një mbrojtje të dobët nga pikëpamja biologjike, gjë që ka lejuar futjen e pakontrolluar të specieve jo-endemike në liqene, duke kërcënuar këto ekosisteme unike.

Peshkimi çlodhës - argëtues: ndërkohë që aktualisht është në nivele të ulëta, ka një hapësirë të konsiderueshme për të zgjeruar peshkimin çlodhës argëtues me vlera të larta, sidomos në ujërat e brendshme. Ky nën-sektor rregullohet nëpërmjet legjislacionit të përgjithshëm për peshkimin dhe akuakulturën, por në thelb mbetet një përqsasje e hapur.

Analiza ekonomike e prodhimit

Lagunat bregdetare: ka një analize jo të saktë ekonomike mbi peshkimin në lagunat e Shqipërisë, ku shumica e prodhimit nuk raportohet. Vlerësohet se këto kanë një vlerë shitjeje të dorës së pare rreth 1.6 milionë EURO, duke mbështetur rreth 250 peshkatarë të licencuar, dhe padyshim shumë të tjerë të pa licencuar.

Ujërat e brendshme: ashtu si peshkimi në laguna, edhe ai në liqene raportohet në nivele konsiderueshëm më të ulëta, por duket se ka një përfitim relativisht më të lartë krahasuar me humbjet në sektorin e detit. Peshkimi në ujërat e brendshme mbështet rreth 650 peshkatarë në liqene dhe 250 peshkatarë të tjerë në rezervuarë.

1.7 Akuakultura

Mjedisi

Shqipëria përfiton prej një game të gjerë të kushteve mjedisore, të cilat mundësojnë zhvillimin e formave të ndryshme të akuakulturës, që nga Deti i thellë Jon deri në bregdetin e cekët të Adriatikut. Kushtet e motit dhe ato hidrologjike i bëjnë ujërat shqiptare të përshtatshme për akuakulturën detare të specieve me vlera të larta siç janë kocja dhe levreku si dhe për kultivimin e troftes në zonat malore.

Prodhimtaria aktuale

Prodhimi i akuakulturës në Shqipëri llogaritet në rreth 1,700 ton peshk dhe 750 ton midhje. Duke përfshirë prodhimin e midhjeve në impiante, sistemet kryesore të prodhimit janë kultivimi në kosha i kocës (982 ton) dhe levrekut (336 ton) me 12 subjekte që punojnë të



gjithë në zonën jugore Vlorë / Sarandë, ku ata shfrytëzojnë ujërat e thella dhe të pastra të Detit Jon.

Prodhimi i troftës në ekonomi është në vendin e dytë, me një prodhimtari prej 379 ton nga 15 operatorë të përqendruar kryesisht në zonat e larta dhe të freskëta të jugut dhe veri - lindjes së Shqipërisë. Sasia prej 180 ton e krapit prodhohet në rezervuare në zonat e ulëta ku temperaturat e ujit janë mjaftueshëm të larta për të garantuar prodhimtarinë në rezervuare dhe rritjen e peshqve të familjes së krapit.

Akuakultura detare: Akuakultura detare është nën-sektori me rritjen më të shpejtë në Shqipëri, por përsëri është shumë i vogël dhe i pa sofistikuar krahasuar me prodhimin e kocës dhe levrekut në Greqi, Itali dhe Turqi. Ekonomia më e madhe e koshave detare prodhon rreth 450 ton në vit dhe ka 28 të punësuar, kurse ekonomia më e vogël prodhon vetëm 12 ton në vit dhe ka 4 të punësuar.

Për momentin, në Shqipëri nuk ka një qendër të prodhimit të rasateve, kështu që rasatet, ashtu si dhe ushqimi, importohen. Pra, ekonomitë shqiptare janë thjesht njësi rritjeje. Përgjithësisht shitjet bëhen tek restorantet dhe dyqanet lokale, por disa përpunues të mëdhenj, blejnë direkt nga ekonomitë.

Megjithëse akuakultura e koshave detare është rritur shpejt që prej vitit 2000, ka shenja se edhe kjo rritje ka problemet e veta. Çmimet e ulëta të shitjes direkt në ekonomi (për shkak të prodhimit të lartë në pjesën tjetër të Mesdheut) dhe kostot e larta të rasateve dhe ushqimeve të importuara, nënkuptojnë se prodhuesit do të vijnë të ndeshen me hapësira të ngushta për fitim.

Akuakultura në ujërat e brendshme: Rritja e troftës ylber (*Oncorhynchus mykiss*) bëhet kryesisht në ekonomi me vaska që përdorin ujë të rrjedhshëm nga lumenjtë. Ekonomitë kanë kapacitete të ndryshme, ku dy prej tyre prodhojnë 75 ton në vit, dhe 12 ekonomitë e tjera prodhojnë më pak se 35 ton. Gjithashtu ka një numër të papërcaktuar ekonomish të vogla familjare që prodhojnë më pak se 5 ton në vit për ushqim familjar dhe shitje lokale. Rreth një e treta e ekonomive të troftës kanë inkubatorët e tyre, por i gjithë ushqimi importohet.

Prodhimi i krapit është vetëm rreth 180 ton, shumë i ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Rënia e sistemeve të akuakulturës ekstensive dhe pushtimi i tokës bujqësore nga zhvillimet urbane, ka sjellë që shumë ujembledhes tashmë nuk funksionojnë dhe kërkesa për ripopullim me krap ka rënë në mënyrë drastike gjatë dekadës së fundit. Aktualisht ka vetëm tre ekonomi aktive të riprodhimit të krapit, me një kapacitet total sipërfaqeje ujore prej 28ha.

Një tjetër fushë e akuakulturës në Shqipëri është ripopullimi i Liqenit të Ohrit me Koran. Programi kryesor periodik është rritja e koranit në vaska rrethore për ripopullim, për të mbështetur këtë peshkim të rëndësishëm komercial. Qendra shtetërore – Stacioni i Linit – në Pogradec prodhon rreth 800,000 rasate 3-4g që hidhen në liqen çdo vjeshtë.

Mbështetja për sektorin

Planifikimi për akuakulturën: Aktualisht, planifikimi për sektorin e akuakulturës përfshihet në Planin e Menaxhimit të Peshkimit dhe Akuakulturës: Aksioni Blu (2011 – 2013).

Ligji i ri për akuakulturën do të përditësojë rregullat e akuakulturës në Shqipëri. Në thelb ky ligj përfshin elemente të tillë siç janë identifikimi i Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (PZA-të). Shtesa të mëtejshme përfshijnë vlerësime të ndikimit në mjedis, kontrolle dhe rregullore specifike për akuakulturën, sidomos me zgjerimin e akuakulturës detare.

Një element i rëndësishëm që mungon në planifikimin e akuakulturës në Shqipëri është mungesa e menaxhimit hapësinor. Ka nevojë për një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të detajuar të zonave potenciale për akuakulturë në Shqipëri, si në det ashtu dhe në tokë, me qëllim identifikimin e ZPA-ve siç promovohet nga GFCM⁵.

⁵ Shqipërisë i kërkohet që të jetë në përputhje me rezolutën GFCM/36/2012/1 për udhëzimet mbi zonat e caktuara për akuakulturë (GFCM, 2012).



Çështje mjedisore: Megjithëse ka kohë që funksionon në Shqipëri, zhvillimi i akuakulturës vijon të jetë, në një masë të madhe, në shkallë të ulët dhe kryesisht semi-intensiv. Megjithatë, ka një interes në rritje nga partnerët e huaj për zhvillimin e akuakulturës si në ujërat detare, ashtu dhe ato të brendshme. Me këtë zgjerim potencial lind nevoja për të siguruar qëndrueshmëri në drejtim të ndikimit në mjedis, përgjegjësisë sociale dhe planifikimit të integruar.

Kyçi në këtë proces do të jetë përcaktimi i zonave të akuakulturës dhe duhet të mbështetet nga VNM dhe studime për kapacitetin mbajtës mjedisor, standarde të rrepta të cilësisë së ujit që janë në linjë me Direktivën Kuadër të BE për Strategjinë Detare dhe Direktivën Kuadër të Ujit, dhe, më e rëndësishmja, përfshirjen së akuakulturës në planifikimin e zhvillimit bregdetar dhe rural.

Analiza ekonomike e prodhimit

Prodhimi total i akuakulturës vlerësohet në 2,500 ton (sebashku me midhjen) me një vlerë prej €7.2 milionë. Ka një sërë faktorësh që ndikojnë në ecurinë ekonomike të akuakulturës në Shqipëri. Kostot për rasat dhe ushqim për prodhuesit shqiptarë, si pjesë e kostove operative, janë më të larta sesa ekuivalentët përkatës në BE, për shkak të mbështetjes tek importi për të dyja këto produkte kyç. Akuakultura në Shqipëri ka rreth 300 të punësuar direkt, dhe një numër prej 1,200 të punësuarish përgjatë gjithë zinxhirit të akuakulturës.

1.8 Përpunimi, tregtimi dhe shpërndarja e peshkut

Tregtimi dhe shpërndarja e peshkut

Zbatimi dhe detyrimi për zbatim i legjisllacionit që lidhet me tregtimin, i cili është në linjë me legjisllacionin e BE, ka një rol të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit në të ardhmen, sidomos për faktin se BE-ja është tregu kryesor.

Stabilimentet që kanë një 'numër të BE' duhet që të zbatojnë legjisllacionin e BE që lidhet me HACCP dhe standardet e tregut, duke investuar në teknologji të reja për të arritur këto standarde. Nga ana tjetër, kjo gjë duhet të nxitë përmirësime në cilësi për tregun e brendshëm, sidomos për përpunuesit që veprojnë në të dyja tregjet.

Burimet më të rëndësishme të importit të peshkut dhe prodhimeve të tjera të detit janë nga Kroacia, Greqia, Italia dhe Maroku. Vendet kryesore të eksportit janë Italia, Spanja dhe Greqia, dhe në një masë më të vogël vendet fqinje Serbia dhe Maqedonia. Mbi 70% e eksporteve përbëhen nga açuga e përgatitur dhe e konservuar.

Infrastruktura e zinxhirit të furnizimit të tregut

Në shumicën e rasteve, struktura e rrjetit të shpërndarjes është e thjeshtë: prodhuesit – përpunuesit – shitësit – konsumatorët.

Stabilimentet private të shpërndarjes së peshkut të freskët apo të përpunuar, që gjenden afër porteve, janë lojtarët kyç në shpërndarjen e peshkut në Shqipëri. Për shkak të pozicionit të tyre të fortë në zinxhirin e përpunimit të tregut, ata ndodhen në pozita të forta për të diktuar çmimin tek peshkatarët, dhe për të negociuar shitjet. Fakti se nuk ka tregje të shitjes me shumicë konsiderohet si pengese e zhvillimit të një sistemi efektiv dhe transparent të shpërndarjes dhe tregimit të peshkut.

Në të gjithë vendin ka një sërë dyqanesh të vogla të shitjes me pakicë, të cilët furnizojnë publikun me peshk dhe ku tregtarët e shumicës reklamojnë produktet e tyre. Shitjet me pakicë përmbajnë një shumëllojshmëri biznesesh; disa dyqane moderne kanë magazinat e tyre të ngrirjes, ndërkohë që shumë tregtarë shesin vetëm duke përdorur strukturat bazë.

Sektori i përpunimit dhe zinxhiri i vlerës

Aktualisht, industria e përpunimit përbëhet nga disa kompani të mëdha përpunuese të një sërë specieve të peshkut, të cilat janë të destinuara për eksport. Qendrat kryesore të përpunimit janë Elbasani, Lezha, Durrësi dhe Saranda. Lënda e parë e importuar vjen ose në formën e blloqeve të ngrira, ose e kriposur në fuçi.



Ka 24 stabilimente eksporti me akreditim nga BE. Shqipëria nuk eksporton produkte ihtike të gjallë të detit qysh prej vitit të largët 1994, duke bllokuar kështu eksportin e molusqeve, ngjales etj drejt vendeve të BE-së. Pjesërisht kjo vjen për shkak të mungesës së kapaciteteve brenda AKU, për të realizuar një monitorim të rregullt, në përputhje me kërkesat e DG SANCO dhe faktorëve të tjerë social – ekonomik.

Çështje ekonomike të zinxhirit të furnizimit me produkte të detit dhe sektori i përpunimit

Pjesa më e madhe e tregtimit dhe shpërndarjes së produkteve të peshkut bëhet përmes stabilimenteve të përpunimit, të cilat mbledhin peshkun prej anijeve sipas marrëveshjeve periodike. Këto marrëveshje janë shumë informale dhe jo të favorshme për peshkatarët/prodhuesit.

Stabilimentet e përpunimit kanë krijuar rrjetin e tyre të blerësve, i cili influencon prodhimin, magazinimin dhe shpërndarjen në tregun e brendshëm, dhe ç' është më e rëndësishmja, çmimin që paguhet tek prodhuesit. Për shkak se në vend nuk ka tregje të shitjes me shumicë për të pasur një tregti të ndershme dhe transparente, ka një mungesë të dukshme transparence në zinxhirin e furnizimit me prodhime deti. Kjo situatë përkeqësohet më tej për shkak të mungesës totale në porte të një sistemi informacioni për çmimet ditore kombëtare/rajonale të shitjes, apo për çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë.

Për speciet fundore, mesatarisht, shitësi me shumicë i shton 28% çmimit të shitjes në bankinë, kurse shitësi me pakicë shton edhe 24%. Kufijtë e shitjes me shumicë janë të larta krahasuar me tregjet e tjera evropiane, gjë që tregon mungesë konkurrence. Kufijtë e shitjes me pakicë janë më të ulëta nga sa pritet (duke reflektuar potencialisht shpenzime më të pakta dhe më shumë konkurrencë mes shitësve me pakicë).

Ka një shkallë sezonale në nën-sektorin e përpunimit – ku lënda e parë importohet, përpunohet dhe ri-eksportohet. Megjithëse nuk ka një regjistrim të qëndrueshëm të punësimit në sektorin e përpunimit të peshkut, rezultatet nga Raporti i Vlerësimit sugjerojnë se në këtë sektor janë rreth 3,000 të punësuar (kryesisht gra). Nisur nga natyra tejet sezonale dhe e përkohshme e punësimit në këtë sektor, kjo shifër mund të jetë, në mënyrë më realiste, e barabartë me rreth 2,000 të punësuar me kohë të plotë. Bazuar në të dhëna historike, punësimi në sektorin e përpunimit ka pësuar rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit.

Kapitulli 2. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMI I POLITIKAVE VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

2.1 Vizioni:

Garantimi i aktiviteteve të peshkimit dhe akuakulturës të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore dhe që menaxhohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë marrjen e përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, si dhe kontribuojnë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim. Burime të shëndetshme peshkore në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme, që shfrytëzohen në një mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar nëpërmjet një partneriteti për bashkëmenaxhimin e zgjuar dhe të bazuar tek njohuritë. Ngritja e një industrie konkurruese dhe të qëndrueshme të akuakulturës, e cila kontribuon në sigurinë ushqimore kombëtare dhe rritjen blu. Organizimi i tregut, cilësisë së peshkut, përpunimit dhe tregtimit, me qëllim rritjen e vlerës së shtuar të nën-sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës.

Objektiva të Nivelit të Lartë: Objektivat e Nivelit të Lartë (ONL) për sektorin, përputhen me objektivat dhe prioritetet e BE të specifikuar në Nenin 2 të Rregullores së Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP)⁶.

⁶Realizimi i këtyre objektivave mbështetet me financim nga BE-ja që është i disponueshem për sektorin në vendet anëtare të BE-së.



Objektivat dhe prioritetet e Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së janë:

1. Garantimi se aktivitetet e peshkimit dhe akuakulturës janë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore në periudhë afatgjatë dhe menaxhohen në një mënyrë që është në përputhje me objektivat për marrjen e përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, si dhe kontribuojnë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim.
2. Aplikimi i përafritit paraprak në menaxhimin e peshkimit, dhe synimi për të garantuar se shfrytëzimi i burimeve të gjalla biologjike detare rivendos dhe ruan popullatat e specieve që janë gjuajtur mbi nivelet, të cilat mund të japin prodhimin maksimal të qëndrueshëm.
3. Zbatimi i përafritit të bazuar tek ekosistemi, për menaxhimin e peshkimit, në mënyrë që të sigurohet se ndikimet negative të aktiviteteve të peshkimit në ekosistemin detar janë minimizuar, dhe se bëhen përpjekje për të siguruar se akuakultura dhe aktivitetet e peshkimit shmangin degradimin e mjedisit detar.
4. Kontributi në mbledhjen e të dhënave shkencore.

Nisur nga fakti që legjislacioni aktual i peshkimit është në linjë me legjislacionin e BE-së, rekomandohet që ONL-të, të kenë parasysh dispozitat e Nenit 2 të Ligjit 'Për Peshkimin', të cilat përfshijnë:

- a. Sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe atyre detare
- b. Përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes
- c. Përcaktimin e masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme.
- d. Garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit, si dhe përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale për prodhuesit.
- e. Nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim.
- f. Sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit.
- g. Hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit
- h. Përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikat evropiane në këtë drejtim.
- i. Ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Këto objektiva përbëjnë bazën për hartimin e objektivave dhe masave ⁷ më specifike të zhvillimit të sektorit në vend, të përcaktuara më poshtë.

Objektivat Specifike të Zhvillimit

Objektivat Specifike të Zhvillimit (OSZH) të kësaj strategjie, janë në linjë me ONL-të dhe më konkretisht:

- Kuadri ligjor, administrativ dhe institucional
- Peshkimi (detar)
- Peshkimi (në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme)
- Akuakultura

⁷Një 'masë' nënkupton një veprim apo aktivitet i ndërmarrë për të arritur një objektiv



- Tregtimi dhe përpunimi

2.2 Kuadri ligjor, administrativ dhe institucional

ONL për forcimin institucional dhe përmirësimin e kontrollit të sektorit është si vijon:

Përafrimi i administrimit dhe legjislacionit të peshkimit me praktikat dhe standardet aktuale të BE për të forcuar kontributin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës në ekonomi dhe për të përgatitur pranimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Objektivat Specifike të Zhvillimit

Përmbushja e ONL-së institucionale/kontrollit përcakton tre OSZH::

- Forcimi i kapacitetit institucional të MBZHRAU për të administruar me efektivitet sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.
- Ngritja e një sistemi transparent, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të bashkëmenaxhimit mes Qeverisë, OMP-ve dhe palëve të tjera të interesuara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe Politikën e peshkimit në Republikën e Shqipërisë.
- Përafrimi i politikës, legjislacionit, menaxhimit dhe procedurave të planifikimit të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës me komponentët përkatës të *Acquis* së Peshkimit.

Justifikimi

Që prej vitit 2005 ka patur disa ndryshime institucionale në administrimin e sektorit. Kufizimet në kontrollin efektiv të sektorit – me një administratë peshkimi jo-funksionale, buxhet dhe kapacitet të kufizuar për të detyruar zbatimin e ligjit – mbeten dobësitë më serioze për sektorin dhe janë shkak për shumë dobësi të tjera të identifikuara. Një grup prej 22 inspektorësh, nën Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (pra jashtë kuadrit kryesor institucional të MBZHRAU) vepron vetëm si monitorues (mbledhës të dhënash) dhe inspektorët janë të shpërndarë në mënyrë jo-proporcionale në gjithë vendin (fare pak prej tyre veprojnë në bregdet) dhe nuk ka mjaftueshëm që të garantojnë një mbulim të mjaftueshëm. Mos-adresimi që në fillim i këtyre mungesave institucionale do të sjellë një mosarritjen e ndikimeve pozitive në sektor prej iniciativave të tjera të zhvillimit të percaktuara në këtë strategji.

OSZH 1: Forcimi i MBZHRAU për të përmirësuar kontrollin

Ristrukturimi institucional i sektorit me një Drejtori të vetme të Peshkimit dhe Akuakulturës, aktualisht kërkon vëmendjen e MBZHRAU. Ristrukturimi dhe forcimi institucional i administratës së peshkimit me personel të mjaftueshëm në të gjitha nivelet, duhet parë si **prioriteti më i madh** i qeverisë në vitin 2017, i shoqëruar me financim të mjaftueshëm për menaxhimin, administrimin, kontrollin (MKV) dhe kërkimin shkencor për peshkimin dhe akuakulturën.

Si pjesë e procesit të ristrukturimit duhet të adresohet edhe roli aktual i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DMSHP) në menaxhimin e aseteve të peshkimit, përfshirë portet,. Gjithashtu, urgjentisht duhet adresuar edhe rivendosja e inspektoratit të peshkimit.

Është e domosdoshme krijimi i një Drejtorie të Peshkimit dhe Akuakulturës me dy sektore:

- Një sektor që fokusohet tek çështjet e menaxhimit – ku përfshihen të gjitha çështjet e politikave dhe të planifikimit si dhe lidhjet me AKU për sigurinë ushqimore, institucione kërkimore dhe industrinë, përmes OMP-ve, organizatave prodhuese dhe grupet e interesit;
- Një sektor që fokusohet tek çështjet operacionale – ku futen detyrimi për zbatimin e ligjit dhe mbledhja grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, dhe përfshin Inspektoratin e Peshkimit.

Drejtoria e propozuar duhet të ketë një personel minimal prej 10 specialistesh (megjithëse, nëse nuk do të kishte kufizime buxhetore, personeli i plotë duhet të ishte rreth 15). Në gjithë



vendin nevojiten 22 inspektorë: nga 3 në Durrës dhe Vlorë dhe nga 2 në Shëngjin dhe Sarandë plus 2 inspektorë në secilin prej liqeneve kryesore dhe nga 1 në secilën prej tetë lagunave.

OSZH 2: Zhvillimi i regjimit të bashkëmenaxhimit

Që në vitin 2002, në të gjithë vendin janë krijuar OMP-të, për të ndërmarrë përgjegjësinë e përdorimit dhe mirëmbajtjes së porteve dhe qëndrave të përmiresuara të peshkimit, dhe për të marrë pjesë në bashkëmenaxhimin e burimeve peshkore në partneritet me administratën e peshkimit. Ky sistem, aktualisht nuk funksionon, veçanërisht në sektorin detar.

Dobësia e administratës së peshkimit dhe e kontrollit në përgjithësi nënkupton se, për momentin, shteti nuk ka mundësi që të zbatojë këto plane, dhe duket se kjo ka çuar drejt një peshkimi të qëndrueshëm ilegal.

OSZH 3: Përafrimi me *Acquis* të Peshkimit

Reforma ligjore që duhet ndërmarrë, si pjesë e procesit të pranimit në BE akoma nuk ka përfunduar. Gjithashtu ka nevojë për një ristrukturim të institucioneve publike që administrojnë sektorin. Ka edhe shumë çështje të tjera themelore të menaxhimit të peshkimit, të cilat kërkojnë zgjidhje. Progres raporti i fundit (KE, 2014) konkludon se:

- Akoma vazhdon të bëhet pak progres në këtë sektor;
- Sektori duhet të konsolidohet më tej, nën një strukturë të vetme në MBZHRAU, si dhe duhet të hartohet një strategji e shëndoshë e sektorit në linjë me politikën e peshkimit të BE (që do të thotë këtë dokument);
- Duhet të forcohet kuadri institucional dhe ligjor, për të garantuar monitorim të rregullt të rezervave peshkore dhe për të përgatitur rregullore për zbatimin e planeve të menaxhimit për speciet e peshkut dhe metodat e peshkimit; dhe,
- Duhet të alokohen burimet e nevojshme financiare për të garantuar monitorimin dhe kontrollin e mjaftueshëm të aktiviteteve të peshkimit. Kjo është thelbësore për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Raporti më i fundit konkludon se “Në përgjithësi, përgatitjet janë në një fazë shumë të hershme.” Nevoja për të pasur një plan strategjik të integruar për sektorin, është shumë e vonuar. Ky dokument i planifikimit strategjik jep një kuadër për identifikimin e fushave prioritare për zhvillimin e sektorit (pavarësisht donatorit) dhe modelin e një projekti më të madh të asistencës teknike, për financim nga BE duke filluar në vitin 2017.

Masat e propozuara

Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
OSZH 1: Forcimi i kapacitetit institucional të MBZHRAU për të administruar me efektivitet sektorin e peshkimit dhe akuakulturës	1.1 Krijimi i Drejtorisë së Peshkimit, plotësisht funksionale, brenda MBZHRAU 1.2 Krijimi i një SIMP plotësisht funksional dhe forcimi i zyrave të porteve të peshkimit
OSZH 2: Ngritja e një sistemi transparent, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të bashkëmenaxhimit mes Qeverisë, OMP-ve, PO-ve dhe palëve të tjera të interesuara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe PPSH.	2.1 Zhvillimi i kapacitetit të strukturave të bashkëmenaxhimit të peshkimit (OMP-të) 2.2 Këshillim funksional nga Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (KKQPA) dhe Komisioni për Koordinimin e Kërkimit Shkencor dhe Teknologjik (KKKSHT)
OSZH 3: Përafrimi i menaxhimit, kontrollit, tregtimit, politikës strukturore, procedurës së planifikimit dhe legjislacionit të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës për komponentët përkatës të <i>Acquis</i> së Peshkimit	1.1 Forcimi i procedurave administrative të PPP dhe përputhja me legjislacionin kyç të BE-së (Projekti i Binjakëzimit) 1.2 Hartimi dhe zbatimi i një Programi Operacional (PO)



2.3 Peshkimi detar dhe bregdetar

ONL-ja për sektorin e peshkimit detar dhe bregdetar është si vijon:

Garantimi që aktivitetet e peshkimit janë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore dhe menaxhohen në mënyrë të tillë që do të sigurojë marrjen e përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, si dhe kontribuojë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim.

Objektivat Specifike të Zhvillimit

Për arritjen e ONL-së së peshkimit detar propozohen tre OSZH:

- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve peshkore detare nëpërmjet një kontrolli efektiv dhe mbështetjes tek të dhënat shkencore të sakta.
- Një flotë detare e suksesshme dhe konkurruese, në ekuilibër me disponueshmërinë e resurseve të peshkimit
- Mirë menaxhimi i mjedisit detar, duke mbështetur një sektor peshkimi artizanal të qëndrueshëm

Justifikimi

OSZH 4: Menaxhimi i burimeve peshkore detare

Sektori varet nga burimet natyrore të rinovueshme, kështu që menaxhimi i qëndrueshëm i këtyre burimeve është madhor.

Për momentin, pjesa më e madhe e burimeve janë të mbi-shfrytëzuara. Është e nevojshme që të mbështeten përpjekjet rajonale për menaxhim për të ecur drejt niveleve të qëndrueshme të shfrytëzimit. Kjo gjë përfshin caktimin dhe zbatimin e masave teknike, krijimin e zonave që do të mbrohen për të arritur objektivat e menaxhimit të peshkimit.

Duke ndjekur një përafrim parandalues, duhen ndërmarrë masa kombëtare aty ku dhe kur është e nevojshme.

Raporti i fundit i GFCM mbi zbatimin e menaxhimit rajonal nga Shqipëria⁸ pranon se, ndërkohë që është hartuar një Ligj i rishikuar për Peshkimin, ku propozohen shumë masa, përsëri nevojiten që këto masa të zbatohen.

Sistemi i Monitorimit të Anijeve (SMA) për anijet e peshkimit mbi 12, duhet të mbështetet me monitorimin efektiv duke çuar në kontrollin e flotës sipas rregullave.

Menaxhimi duhet të mbështetet mbi një shkencë të shëndoshë. Pjesa më e madhe e rezervave të peshkut me vlerë tregtare, që peshkohet nga flota, është e shpërndarë në detet Adriatik dhe Jon, duke treguar që niveli më i përshtatshëm i menaxhimit të peshkimit duhet të bazohet në nivel baseni detar rajonal.

Menaxhimi rajonal është në përputhje me Ligjin 'Për Peshkimin', i cili kërkon "*aplikimin e një përafrimi racional në zbatimin e masave që synojnë mbrojtjen dhe konservimin e burimeve të organizmave/krijesave detare, duke ruajtur ndërkohë diversitetin e tyre biologjik*". Nga ana tjetër, kjo është në linjë me këshillimin shkencor dhe propozimet e menaxhimit nga Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM).

Aktualisht Shqipëria merr pjesë në GFCM dhe projektin Adriamed, por ka mungesë të kapaciteteve për angazhim më aktiv në zhvillimin e këshillimit shkencor rajonal. Duhet të alokohen burime të mjaftueshme që ta lejojnë Shqipërinë që të kontribuojë plotësisht në aktivitetet rajonale të shkencës dhe menaxhimit të peshkimit. Gjithashtu kërkohet edhe

⁸Raporti i fundit i Komitetit të GFCM për Përrputshmërinë, në maj 2014 (GFCM, 2014) raporton sa më poshtë lidhur me zbatimin nga Shqipëria të vendimeve të GFCM: "*Shqipëria: janë raportuar disa boshllëqe në zbatimin e vendimeve të GFCM, si dhe disa vështirësi që lidhen me transmetimin e të dhënave nga Shqipëria në kohën e duhur. Disa rekomandime të GFCM janë përfshirë në legjilacionin kombëtar dhe Shqipëria ka bërë përpjekje që të detyrojë zbatimin e tyre në nivel kombëtar, megjithëse nevojitet ngritja e kapacitetit për një monitorim, kontroll dhe vëzhgim efektiv.*"



trajnim profesional për të rritur kapacitetin e sektorit publik në menaxhimin shkencor të peshkimit.

Një menaxhim efektiv kërkon informacion të mjaftueshëm. Mbledhja e të dhënave në sektor është minimale dhe sasi të konsiderueshme të zënieve nuk raportohen.

OSZH 5: Një flotë detare e suksesshme dhe konkurruese, në ekuilibër me mundësitë

Flota e peshkimit detar në Shqipëri karakterizohet nga anije të vjetra (mosha mesatare 39 vjeçare, krahasuar me mesataren 21 vjeçare të BE-së) dhe shumë prej tyre janë në një gjendje të keqe teknike. Investimi shumë i pakët tek flota (lidhur me anijet, riparimet dhe pajisjet) tregon për performancën e dobët ekonomike shumëvjeçare të flotës detare. Ekonomia informale që mbizotëron në sektor po dëmton operatorët e ligjshëm dhe është një frenim për investime.

Ndërkohë që kjo performancë e dobët ekonomike mund të duket se vjen si pasojë e pranisë së shumë anijeve që peshkojnë pak peshk, duhet theksuar se flota shqiptare prej rreth 213 anije mbi 12 m të licencuara (nga të cilat vetëm 118 janë aktive) përbën më pak se 8% të flotës së tratave koce në Adriatik.

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve peshkore, përmirësimi i kostove të karburantit dhe riparimit, së bashku me tregtimin më të mirë të prodhimit, mund të bëjë që kapaciteti që sot është inaktiv të bëhet aktiv. Ky do të ishte një zhvillim pozitiv për sektorin dhe ekonominë shqiptare, nëse bëhet në një mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme. Përsëri kjo thekson nevojën për të përmirësuar drejtimin në përgjithësi (reduktuar informalitetin në sektor) për të identifikuar qartë dhe mbrojtur aktivitetet e ligjshme, përpara se të jepet mbështetja financiare.

Ka një mungesë qartësie se cila agjenci ka përgjegjësinë për katër portet e peshkimit dhe asnjë menaxhim nuk është i dukshëm. Kjo ka kontribuar në faktin që të katër portet kryesore janë në një gjendje të varfër. Mbetjet e anijeve të mbytura në port nuk janë larguar duke shkaktuar rreziqe të mëdha për lundrim. Shumica e anijeve, bankinave dhe infrastrukturës kanë nevojë për riparime, gjë që prek sigurinë në port dhe sjell mundësi të kufizuar për magazinim dhe ngrirje (përveç disa magazinave të sektorit privat) ndikon negativisht në cilësinë dhe prodhimin.

Në Durrës është ndërtuar një port i ri, i cili pritet që të përmirësojë efektivitetin e flotës aktive. Megjithatë, përsëri mbetet problemi i mungesës së strukturave të riparimit dhe i pranisë së strukturave të degraduara në portet e tjera. Anijet i kryejnë riparimet në Itali apo Greqi. Kjo ndikon në performancën ekonomike të flotës (kosto shtesë prej gati €0.5 milionë) dhe kostot e riparimit (llogaritur në €4.3 milionë në vit) humbasin për ekonominë shqiptare.

Niveli i ulët i flotës shqiptare sugjeron se investime të konsiderueshme siç janë shkallë riparimi në tokë dhe disa investime strategjike në shkallë riparimi me rreshqitje dhe struktura riparimi janë të domosdoshme për flotën.

OSZH 6: Mirë menaxhimi i mjedisit detar, duke mbështetur një peshkim artizanal të qëndrueshëm

Sektori artizanal përbëhet kryesisht nga anije të vogla (nën 12m), dhe, ashtu si dhe flota detare, karakterizohet nga anije të vjetra dhe mundësi minimale financiare për investime. Peshkimi bregdetar raporton prodhim të ulët. Sektori artizanal ka një spektër të kufizuar peshkimi dhe kryesisht vuan nga një mjedis lokal i degraduar.

Ndërkohë që zonat pranë bregut, brenda distancës prej 3 milje dhe habitatet e prekshme (livadhet e Posidonias, etj.) duhet të jenë të mbyllura për tratat fundore, raportohen një sërë shkeljesh. Trysnia nga zhvillimi, siç është sektori i ndërtimeve, gjithashtu degradon habitatet pranë bregut, ndërkohë që nuk ka një sistem efektiv të detyrimit për zbatim të ligjit dhe një menaxhim efektiv në këto ujëra. Menaxhimi i lokalizuar, që përfshin personat që mbështeten tek mjedisi detar, ose mungon ose nuk është efektiv, përgjatë gjithë mjedisit bregdetar shqiptar.

Masat e propozuara



Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
OSZH 4: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve tregtare detare nëpërmjet një kontrolli efektiv dhe mbështetjes tek shkenca e saktë.	1.1 Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Rezervave 1.2 Ngritja e sistemit të Monitorim, Kontroll, Vëzhgimit (MKV), për të detyruar zbatimin e rregulloreve të peshkimit. 1.3 Krijimi i një kuadri kombëtar i mbledhjes së të dhënave për peshkimin 1.4 Ngritja e kapacitetit kombëtar të shkencës së peshkimit & plane kërkimore
OSZH 5: Një flotë detare e suksesshme dhe konkurruese	2.1 Rishikimi i kapacitetit, aktivitetit dhe potencialit për diversifikim të flotës me qëllim ri-ekuilibrimin në linjë me burimet peshkore 2.2 Mbështetje për modernizimin e flotës dhe diversifikimin në forma të reja të peshkimit 2.3 Krijim dhe modernizim i infrastrukurës tokësore për të mbështetur menaxhimin e flotës, mirëmbajtjen, dhe aktivitetet pas peshkimit.
OSZH 6: Mirë menaxhimi i mjedisit detar, duke mbështetur një sektor peshkimi artizanal të qëndrueshëm	3.1 Hartimi i Planeve të Menaxhimit Bregdetar për peshkimin dhe mbrojtjen e mjedisit (me iniciativa më të gjera të MIZB, aty ku ka) 3.2 Ngritja e grupeve të menaxhimit bregdetar & rrjeteve përfaqësuese për të hartuar dhe zbatuar Planet e Menaxhimit Bregdetar. 3.3 Identifikimi i zonave kritike të peshkimit dhe habitateve kritike natyrore që kërkojnë mbrojtje shtesë

2.4 Peshkimi në lagunat bregdetare dhe në ujërat e brendshme

ONL-ja e propozuar për sektorin e peshkimit në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme është si më poshtë:

Burime të qëndrueshme peshkore në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme, të cilat (burimet) shfrytëzohen në një mënyrë të përgjegjshme dhe të kontrolluar nëpërmjet një partneriteti për bashkëmenaxhimin e zgjuar dhe të bazuar tek njohuritë.

Objektivat Specifike të Zhvillimit

Lidhur me peshkimin në lagunat bregdetare dhe në ujërat e brendshme në Shqipëri janë propozuar katër OSZH:

- Menaxhimi i peshkimit në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme bazohet në një njohje të mirë të rezervave, sforcos së peshkimit dhe nevojave të personave që mbështeten tek ky peshkim për të siguruar jetesën
- Sforcoja e peshkimit është në përpjesëtim të drejtë me prodhimin maksimal të qëndrueshëm dhe disponueshmërinë e rezervave të peshkore.
- Një sistem menaxhimi dhe detyrimi për zbatim të ligjit, i cili kontrollon përfaqesjen ndaj rezervave peshkore në një mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme.
- Vendosja e një peshkimi të qëndrueshëm argëtues në bregdet, lumenjtë dhe liqenet e Shqipërisë.

Justifikimi

Peshkimi në lagunat bregdetare dhe në ujërat e brendshme në Shqipëri përdor shumëllojshmërinë e burimeve të ndryshme lagunore, liqenore dhe të rezervuarëve që ofron vendi. Ndërkohë që prodhimi është mesatar, pjesa më e madhe e këtij peshkimi bëhet nga individë apo nga njësi të vogla peshkimi në komunitete relativisht të varfra, dhe ka një kontribut shpërpjeshtimisht të lartë në ekonominë rurale të Shqipërisë.



OSZH 7: Menaxhimi i peshkimit në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme bazohet në një njohje të mirë të rezervave, sforcos së peshkimit dhe nevojave të personave që mbështeten tek ky peshkim për të siguruar jetesën.

Kohët e fundit ka një fokus, shpesh edhe ndër-kufitar për peshkimin në liqenet e mëdhenj të Shqipërisë, përsëri ka njohuri të kufizuara mbi funksionimin e ekosistemit të tyre, prodhimtarinë dhe vdekshmërinë peshkore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për lagunat bregdetare, pasi këto 'zona të nxehta' nga pikëpamja e biodiversitetit dhe shumë produktive, janë të prekshme si nga mbi-shfrytëzimi ashtu dhe nga ndryshimet antropogjenike.

Liqenet e mëdhenj janë më të stabilizuar, por përsëri kanë qenë subjekt i një ndikimi të konsiderueshëm prej trysnisë së peshkimit, ndotjes dhe futjes së specieve jo-indigjene, me pasoja mbi rendimentin e peshkimit. Pra, ka një nevojë urgjente për të siguruar më shumë njohuri mbi statusin dhe funksionimin e këtyre sistemeve, me qëllim lejimin e një përafrimi racional dhe shkencor të menaxhimit të tyre.

Hartimi i një Plani Kombëtar të Menaxhimit të Ligatinave si mjedise ku ndërthuren shumë aktorë dhe faktorë do të ishte një iniciativë e arsyeshme, logjiksht në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, pra jashtë hapësirës së kësaj strategjie.

OSZH 8: Sforcoja e peshkimit është në përpjesëtim të drejtë me prodhimin maksimal të qëndrueshëm dhe disponueshmërinë e rezervave të peshkore.

Edhe pse mungon njohuria e saktë shkencore mbi rendimentet potenciale të peshkimit, është e rëndësishme të garantohet se sforcoja e peshkimit nuk e tejkalon kapacitetin prodhues të këtyre mjediseve ujore.

Deri më sot është bërë vetëm një përpjekje e pjesshme për të kufizuar kapacitetin dhe sforcon e peshkimit, dhe kjo shpesh ka qenë subjekt i trysnisë politike.

Është e rëndësishme të vendosen mekanizma kontrolli, të cilat kufizojnë licencimin për peshkimin e rezervave të disponueshme peshkore. Këto do të përfshihen në Planet e Menaxhimit të Peshkimit për të tetë lagunat e mëdha bregdetare dhe për ujërat e brendshme.

Në disa raste do të ishte e përshtatshme që të mbështetej prodhimtaria natyrore përmes ripopullimit, për shembull të troftës endemike në liqenet kryesore dhe të krapit dhe specieve të tjera në kategoritë më të vogla ujore.

OSZH 9: Një sistem menaxhimi dhe detyrimi për zbatim të ligjit, i cili kontrollon qasjen ndaj rezervave peshkore në një mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme.

Rregulloret e peshkimit janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara. Megjithatë aftësia për të zbatuar regjimin rregullator është e kufizuar për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare si dhe mungesës së një strategjie të fortë të monitorim, kontroll, vëzhgimit (MKV) për lagunat dhe ujërat e brendshme. Si rezultat, peshkimi ilegal, i paraportuar dhe i parregulluar (IUU) është një fenomen i zakonshëm dhe kërcënon potencialin e këtyre sistemeve ujore për të siguruar një mënyrë jetese të qëndrueshme për komunitetet lokale.

OSZH 10: Vendosja e një peshkimi të qëndrueshëm çlodhës argëtues në bregdet, lumenjtë dhe liqenet e Shqipërisë.

Me gjithë shtrirjen dhe shumëllojshmërinë e ujërave bregdetare dhe të brendshme, peshkimi çlodhës argëtues është pak i zhvilluar në vendin tone dhe ka interes të ulët. Nëse zhvillohet dhe menaxhohet me kujdes, ai ka potencialin që të sigurojë mundësi të konsiderueshme jetese për komunitetin, si dhe të kontribuojë në mirëqenien e tyre sociale. Për më tepër, ka potencial për të diversifikuar industrinë e turizmit në Shqipëri përmes 'turizmit të peshkimit'. Sidoqoftë, kjo do të kërkojë planifikim të kujdesshëm për të maksimizuar gjenerimin e të ardhurave dhe mundësitë për të siguruar jetesën në periudhë afatgjatë.

Masat e propozuara

Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
----------------------------------	-------------------------



Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
OSZH 7: Menaxhimi i peshkimit në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme bazohet në një njohje të mirë të rezervave, sforcos së peshkimit dhe nevojave të personave që mbështeten tek ky peshkim për të siguruar jetesën	4.1 Zhvillimi i kapacitetit të menaxhimit të peshkimit për kategorite ujore kombëtare dhe të përbashkëta me vendet fqinje 4.2 Hartimi i një programi kërkimor periodik, i cili identifikon dhe adreson boshllëqet në informacionin prioritar për një menaxhim të qëndrueshëm.
OSZH 8: Sforcoja e peshkimit është në përpjesëtim të drejtë me prodhimin maksimal të qëndrueshëm të rezervave të disponueshme peshkore.	5.1 Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Peshkimit për të gjitha lagunat dhe ujërat e brendshme, përfshirë ripopullimin, aty ku është i përshtatshëm 5.2 Ngritja e një sistemi licencimi të peshkimit, i cili (sistemi) është gjithëpërfshirës, transparent dhe i bazuar në njohuritë, në mënyrë që kapaciteti i peshkimit të jetë i kontrolluar dhe brenda kufijve biologjikë.
OSZH 9: Një sistem menaxhimi dhe detyrimi për zbatim të ligjit, i cili kontrollon qasjen ndaj rezervave peshkore në një mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme.	6.1 Hartimi i një strategjie të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të MKV për kategorite ujore bregdetare dhe të brendshme si pjesë e përafrimit me të gjerë të bashkëmenaxhimit, e kombinuar me forcimin institucional dhe trajnimin mbi teknikat e MKV-së.
OSZH 10: Vendosja e një peshkimi të qëndrueshëm çlodhës argëtues në bregdet, lumenjtë dhe liqene.	7.1 Përmirësimi i regjimit të peshkimit çlodhës argëtues, me qëllim maksimizimin e investimit dhe mundësive për përmirësimin e mënyrës së jetesës, në këtë fushë të re në zgjerim.

2.5 Akuakultura

ONL-ja e propozuar për sektorin e akuakulturës është si më poshtë:

Ngritja e një industrie konkurruese dhe të qëndrueshme të akuakulturës, e cila kontribuon në sigurinë ushqimore kombëtare dhe rritjen blu

Objektivat Specifike të Zhvillimit

Për të arritur ONL-në e akuakulturës janë propozuar katër OSZH:

- Zhvillimi i sektorit të akuakulturës përmes një përafrimi të planifikimit strategjik gjithëpërfshirës dhe të bazuar tek ekosistemi, planifikim i cili rishikohet dhe përditësohet periodikisht.
- Lehtësimi i investimeve në akuakulturë përmes caktimit të Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë, si pjesë e planit hapësinor ndër sektorial detar dhe të ujërave të brendshme.
- Një industri akuakulturë e shumëllojshme, kompetente teknikisht dhe konkurruese ndërkombëtarisht, e cila funksionon në tregun vendas, dhe kontribuon në prodhimin evropian të produkteve të detit.
- Krijimi një sinergjie mes programeve kërkimore kombëtare dhe bashkëpunim mes industrisë dhe komunitetit shkencor.

Justifikimi

Është e qartë që në të ardhmen çdo rritje e prodhimit të produkteve të detit do të vijë nga akuakultura. Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm, me një vijë të gjatë dhe të ndryshueshme bregdetare, shumë burime të ujërave të ëmbla dhe shumë ujembledhes vaditje. Megjithatë, pavarësisht një trashëgimie të fortë historike të akuakulturës tradicionale të peshkut dhe molusqeve, dhe kalimit prej prodhimit ekstensiv të ciprinidëve, në rritjen gjysmë-intensive të peshqve detarë, prodhimtaria e akuakulturës ka mbetur në vend gjatë tetë viteve të fundit, në rreth 2,500 tonë në vit.

Shkaqet pse akuakultura nuk ka vijuar të rritet janë të ndryshme, por kryesisht burojnë nga nivelet e ulëta të teknologjisë dhe të menaxhimit të përdorur, varësisë nga importi i



materialeve të kushtueshme, siç janë rasatet dhe ushqimi, duke e bërë më pak konkurruese sesa aktivitetet më të mëdha dhe më efektive në Greqi, Kroaci dhe Itali.

OSZH 11: Zhvillimi i sektorit të akuakulturës përmes një përafrimi të planifikimit strategjik gjithëpërfshirës dhe të bazuar tek ekosistemi, planifikim i cili rishikohet dhe përditësohet periodikisht.

Nevoja kryesore është përgatitja e një plani zhvillimi të detajuar dhe afatgjatë për akuakulturën. Kjo është në përputhje me BE, ku kërkohet një 'plan strategjik kombëtar shumëvjeçar për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës' për periudhën 2014 – 2020 që të përputhet me periudhën e programimit të EMFF. Hartimi i këtij plani për Shqipërinë konsiderohet si kolona kryesore e masave që lidhen me akuakulturën, të hartuara në kuadër të kësaj strategjie të sektorit të peshkimit.

OSZH 12: Lehtësimi i investimeve në akuakulturë përmes identifikimit të zonave të Përcaktuara për akuakulturë (ZPA), si pjesë e planit hapësinor ndërsektorial detar dhe të ujërave të brendshme.

Një element kyç është rritja e shpejtë e "konkurrencës" për hapësirat bregdetare dhe të ujërave të brendshme në Shqipëri, sidomos ato që lidhen me zhvillimin urban, turizmin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ka një nevojë urgjente për të integruar akuakulturën në planifikimin hapësinor të përdorimit të tokës dhe detit, me qëllim identifikimin e 'zonave të përcaktuara për akuakulturë' (ZPA) në një shkallë që të jetë proporcionale me përafrimin e ekosistemit në akuakulturë. E lidhur me këtë është dhe nevoja për një sistem të mirë organizuar për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës, zonë pas zone, duke marrë në konsideratë çështje të tilla si madhësinë dhe përshtatshmërinë e investimit, qëndrueshmërinë e tij mjedisore si dhe ndikimin e tij individual dhe të kombinuar mbi përdoruesit e tjerë të detit dhe tokës.

OSZH 13: Një industri akuakulture e shumëllojshme, kompetente teknikisht dhe konkurruese ndërkombëtarisht, e cila funksionon në tregun vendas, dhe kontribuon në prodhimin evropian të produkteve të detit.

Një çështje tjetër e rëndësishme është niveli i ulët i konkurrueshmërisë së akuakulturës shqiptare. Kjo konkurrencë ka nevojë për një sërë përafrimesh, përfshirë ngritjen e kapacitetit për të prodhuar një sërë elementësh kyç, siç janë rasatet dhe ushqimi, dhe materiale të tjera të kushtueshme të importit. Ky përafrim mund të kërkojë studime fizibiliteti me fokus të përcaktuar, dhe krijimin e lidhjeve strategjike me partnerë të huaj që kanë eksperiencë. Ky përafrim mund të plotësohet me diversifikimin e aktiviteteve të akuakulturës në Shqipëri për të prodhuar një shumëllojshmëri produktesh, përfshirë metodat organike me vlera të larta, si dhe shtimin e vlerës përmes metodave të reja të përpunimit dhe përafrimeve të reja të tregtimit.

OSZH 14: Krijimi sinergjise mes programeve kërkimore kombëtare dhe bashkëpunim mes industrisë dhe komunitetit shkencor.

Sektori aktual i akuakulturës është i copëzuar, me pak sinergji. Kjo vjen prej mungesës së bashkëpunimit për të adresuar çështje të madhësisë së fermave, prej integritimit vertikal dhe kombinimit të burimeve për të kryer kërkime shkencore. Kjo gjë do të duhet të adresohet përmes krijimit të sinergjive mes programeve kërkimore kombëtare dhe bashkëpunimit mes industrisë dhe komunitetit shkencor.

Masat e propozuara

Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
OSZH 11: Zhvillimi i sektorit të akuakulturës përmes një përafrimi të planifikimit strategjik gjithëpërfshirës dhe të bazuar tek ekosistemi, planifikim i cili rishikohet dhe përditësohet periodikisht.	8.1 Hartimi i një plani strategjik kombëtar shumëvjeçar për akuakulturën, që të mbështetë zhvillimin dhe inovacionin, dhe të inkurajojë aktivitetin ekonomik, diversifikimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat bregdetare dhe ato të brendshme.



Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
OSZH 12: Lehtësimi i investimeve në akuakulturë përmes identifikimit të zonave të përcaktuara për akuakulturë, si pjesë e planit hapësinor ndërsektorial detar dhe të ujërave të brendshme.	<p>9.1 Integrimi i akuakulturës në planifikimin hapësinor detar, bregdetar dhe të ujërave të brendshme, në nivel kombëtar dhe ndër-kufitare përmes konsultimit, dialogut ndër-sektorial, zonimit të bazuar në GIS dhe ndryshimeve në akuakulturë, duke lejuar identifikimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë në det dhe në tokë, përfshirë vlerësimet e përgjithshme për kapacitetin mbajtës mjedisor.</p> <p>9.2 Ngritja e një sistemi efektiv dhe transparent të lejeve dhe licencave për akuakulturën, i cili mbron interesat e investitorëve dhe nxit përcaktimin e një hapësire racionale dhe të qëndrueshme për akuakulturë.</p>
OSZH 13: Një industri akuakulture e shumëllojshme, kompetente teknikisht dhe konkurruese ndërkombëtarisht, e cila funksionon brenda, dhe kontribuon në prodhimin evropian të produkteve të detit.	<p>10.1 Adresimi i problemeve kryesore në konkurrueshmërinë e akuakulturës në vend përmes zhvillimit strategjik të prodhimeve ujore dhe disponibilitetit të rasateve të peshqve.</p> <p>10.2 Përmirësimi i shumëllojshmërisë, vlerës dhe cilësisë së produkteve të akuakulturës, që reflekton nivelet dhe llojet e ndryshme të akuakulturës.</p> <p>10.3 Bashkëpunimi me partnerë të huaj me eksperiencë për të prezantuar teknologji dhe aftësi të reja në akuakulturë.</p>
OSZH 14: Krijimi sinergjive mes programeve kërkimore kombëtare dhe bashkëpunim mes industrisë dhe komunitetit shkencor.	11.1 Një platformë kombëtare kërkimi për akuakulturën (e integruar në strategjinë më të gjerë të kërkimit shkencor – OSZH 4) për të përmirësuar organizimin dhe bashkëpunimin në menaxhimin, prodhimin, kërkimin dhe zhvillimin e akuakulturës në Shqipëri.

2.6 Përpunimi, tregtimi dhe shpërndarja e peshkut

ONL-ja e propozuar për zinxhirin e përpunimit dhe tregtimit është si më poshtë:

Organizimi i tregut, cilësisë së peshkut, përpunimit dhe tregtimit, me qëllim rritjen e vlerës së shtuar të nën-sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës

Objektivat Specifike të Zhvillimit

Për arritjen e ONL-së propozohen dy OSZH:

- Përmirësimi dhe mbështetja e kushteve të higjienës dhe shëndetit të publikut
- Rritja e transparencës së tregut dhe forcimi i menaxhimit të tregut

Justifikimi

OSZH 15: Përmirësimi i sigurisë ushqimore dhe kontrollit të higjienës

Strategjia ndër-sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri (MBZHRAU, 2014) pranon se ka mungesa në drejtim të standardeve të higjienës, sidomos për midhjen dhe molusqet bivalvorë, gjë që ka penguar eksportin e këtyre produkteve. Ka nevojë për forcim institucional të autoriteteve përkatëse të sigurisë ushqimore, për të garantuar së AKU përputhet me legjislacionin e BE, në mënyrë që kompanitë e licencuara të vazhdojnë të kenë qasje tek tregjet e rëndësishme të BE-së. Strategjia duhet të mbështetet mbi mësimet e nxjerra nga mbështetja e mëparshme ndaj ISUV dhe AKU përmes një projekti të BE.

OSZH 16: Rritja e transparencës dhe forcimi i menaxhimit të tregut



Ka qene planifikuar ndërtimi i një tregu të shitjes me shumicë të peshkut në portin e ri të Durrësit (siç propozohet në studimin e parë të fizibilitetit). Në vijim, duhet marrë në konsideratë besueshmëria e një tregu kombëtar modern të shitjes me shumicë të peshkut, me shërbimet dhe strukturat mbështetëse, i cili mund të mbështetë mundësi zëvendësimi, por edhe të rritë mundësitë për eksporte, veçanërisht në BE.

Në vend nuk ka zyrtarisht Organizata të Prodhuesve (OP). Ndërkohë që ka një nevojë për të rritur kapacitetet e OMP-ve detare për tregtimin e prodhimit, kjo mund të arrihet përmes krijimit efektiv të OP-ve të peshkimit, të cilat brenda BE-së janë në mënyrë unike në gjendje që të imponojnë tek anijet rregullat e dorëzimit dhe tregtimit të prodhimit, brenda një porti apo rajoni. Rritja e të ardhurave mbetet një problem për prodhuesit, pasi sektori i peshkimit detar dominohet nga marrëveshje periodike kontraktuale të cilat lidhen me blerësit/përpunuesit e mëdhenj. Përfitimet që vijnë nga kthimi i OMP-ve në OP janë në aftësimin e tyre për të konkurruar në treg dhe për të marrë fuqi. Në shumë raste, OP-të në vendet anëtare të BE-së janë krijuar përmes amendimit dhe adoptimit të organizatave ekzistuese të peshkatarëve (siç janë OMP-të). Edhe ngritja e një apo më shumë tregjeve të shitjes me shumicë, do të ndihmojë në adresimin e këtij problemi të tregut, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme të një tregu të pavarur, transparent dhe konkurrues, të disponueshëm për të gjithë sektorët e industrisë.

Duhet marrë në konsideratë ngritja e një sistemi të thjeshtë informacioni mbi tregtimin e peshkut, për të ndihmuar administratën që të ndjekë funksionimin e tregut dhe për të mbledhur të dhëna me qëllim përmirësimin e kontrollit të sektorit.

Peshkimi artizanal në bregdet, laguna dhe ujërat e brendshëm vuan nga mungesa e konkurrencës, pasi ata nuk kanë një treg të përbashkët dhe kanë opsione të kufizuara të shitjes (vetëm një apo dy blerës kryesorë). Grupet artizanale duhet të identifikojnë mundësitë e përbashkëta për tregti, të mbështetura nga infrastruktura përkatëse, gjë që do të përmirësonte cilësinë, reduktonte humbjet dhe zgjeronte mundësitë e shitjes.

Masat e propozuara

Objektiva Specifike e Zhvillimit	Masat që duhen adoptuar
OSZH 15: Përmirësimi dhe mbështetja e kushteve të higjienës dhe shëndetit të publikut	12.1 Institucionale – Forcimi i kapacitetit të Autoritetit Kompetent për Sigurinë Ushqimore
OSZH 16: Rritja e transparencës dhe forcimi i menaxhimit të tregut	13.1 Institucionale /Administrative – Projekt pilot për krijimin e një Organizate Prodhuesish të peshkimit, funksionale dhe të njohur ligjërisht 13.2 Administrative/Investime – Ngritja e një tregu funksional të shitjes me shumicë të peshkut dhe e një sistemi funksional të informacionit mbi tregun 13.3 Mbështetje tregtimi për sektorin e peshkimit artizanal



Kapitulli 3. OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE.

Fusha	Objektivat e Politikës	Produktet Madhore
Kuatrë ligjor, administrativ dhe institucional	Forcimi i kapacitetit institucional të MBZHRAU për të administruar me efektivitet sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.	Krijimi i Drejtorisë së Peshkimit, plotësisht funksionale, brenda MBZHRAU; Krijimi i një Sistemi të Informacionit të Menaxhimit të Peshkimit (SIMP) plotësisht funksional dhe forcimi i zyrave të porteve të peshkimit.
	Ngritja e një sistemi transparent, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të bashkëmenaxhimit mes Administratës, OMP-ve dhe palëve të tjera të interesuara, në përputhje me kuadrin ligjor.	Zhvillimi i kapacitetit të strukturave të bashkëmenaxhimit të peshkimit (OMP-të); Këshillim funksional nga Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (KKQPA) dhe Komisioni për Koordinimin e Kërkitim Shkencor dhe Teknologjik (KKKSHT).
	Përafrimi i politikës, legjislativ, menaxhimit dhe procedurave të planifikimit të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës me komponentët përkatës të Acquis së Peshkimit.	Forcimi i procedurave administrative dhe përputhja me legjislacionin kyç të BE-së (Projekte Binjakëzimi) Hartimi dhe zbatimi i një Programi Operacional.
Peshkimi detar dhe bregdetar	Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve tregtare detare nëpërmjet një kontrolli efektiv dhe mbështetjes tek shkenca e saktë.	Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Rezervave Ngritja e sistemit të Monitorim, Kontroll, Vëzhgimit (MKV), për të detyruar zbatimin e rregulloreve të peshkimit. Krijimi i një kuadri kombëtar i mbledhjes së të dhënave për peshkimin Ngritja e kapacitetit kombëtar të shkencës së peshkimit & plane kërkimore
	Një flotë detare e suksesshme dhe konkurruese, në ekulibër me mundësitë e disponueshme të peshkimit	Rishikimi i kapacitetit, gjallërisë dhe potencialit për diversifikim të flotës me qëllim ri-ekulibrimin në linjë me burimet peshkore Mbështetje për modernizimin e flotës dhe diversifikimin në forma të reja të peshkimit Krijim dhe modernizim i infrastrukturës tokësore për të mbështetur menaxhimin e flotës, mirëmbajtjen, dhe aktivitetet pas peshkimit.
	Mirë menaxhimi i mjedisit detar, duke mbështetur një sektor peshkimi artizanal të qëndrueshëm	Hartim i Planeve të Menaxhimit Bregdetar për peshkimin dhe mbrojtjen e mjedisit (me iniciativa më të gjera të MIZB, aly ku ka) Ngritja e grupeve të menaxhimit bregdetar & rrezeve përfaqësuese për të hartuar dhe zbatuar Planet e Menaxhimit Bregdetar. Identifikimi i zonave kritike të peshkimit dhe habitateve kritike natyrore që kërkojnë mbrojtje shtesë
Peshkimi në lagunat bregdetare dhe në ujërat e brendshme	Menaxhimi i peshkimit në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme bazohet në një njohje të mirë të rezervave, sforcos së peshkimit dhe nevojave të personave që mbështeten tek ky peshkim për të siguruar jetesën	Zhvillimi i kapacitetit të menaxhimit të peshkimit për masat ujore kombëtare dhe të përbashkëta me vendet fqinje Hartim i një programi kërkimor periodik, i cili identifikon dhe adreson boshllëqet në informacionin prioritar për një menaxhim të qëndrueshëm.
	Sforcoja e peshkimit është në përpjesëtim të drejtë me prodhimin maksimal të qëndrueshëm të rezervave të disponueshme peshkore.	Hartim i Planeve të Menaxhimit të Peshkimit për të gjitha lagunat kyç dhe masat ujore të brendshme, përfshirë ripopullimin, aly ku është i përshatshëm Ngritja e një sistemi licencimi të peshkimit, i cili (sistemi) është gjithëpërfshirës, transparent dhe i bazuar në njohuritë, në mënyrë që kapaciteti i peshkimit të jetë i kontrolluar dhe brenda kufijve biologjikë
	Një sistem menaxhimi dhe detyrimi për zbatim të ligjit, i cili	Hartim i një strategjie të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të MKV për masat ujore bregdetare dhe të brendshme si

Akuakultura	kontrollon përfaqsimin ndaj rezervave peshkore në një mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme.	pjesë e përafritim me të gjera të bashkëmenaxhimit, e kombinuar me forcimin institucional dhe trajnimin mbi teknikat e MKV-së.
	Vendosja e një peshkimi të qëndrueshëm çlodhës argëtues në brigjet, lumenjtë dhe liqenet e Shqipërisë.	Përmirësimi i regjimit të peshkimit çlodhës argëtues, me qëllim maksimizimin e investimit dhe mundësive për përmirësimin e mënyrës së jetesës, në këtë fushë të re në zbatim.
	Zhvillimi i sektorit të akuakulturës përmes një përafritim të planifikimit strategjik gjithëpërfshirës dhe të bazuar tek ekosistemi, planifikim i cili rishikohet dhe përditesohet periodikisht.	Hartim i një plani strategjik kombëtar shumë-vjeçar për akuakulturën, që të mbështetë zhvillimin dhe inovacionin, dhe të inkurajojë aktivitetin ekonomik, diversifikimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat bregdetare dhe ato të brendshme
	Lehtësimi i investimeve në akuakulturë përmes identifikimit të zonave të caktuara për akuakulturë, si pjesë e planit hapësor ndërsektorial detar dhe të ujërave të brendshme.	Integrimi i akuakulturës në planifikimin hapësor detar, bregdetar dhe të ujërave të brendshme, në nivele kombëtare dhe ndër-kufitare përmes konsultimit, dialogut ndër-sektorial, zonimit të bazuar në GIS dhe ndryshimeve në akuakulturë, duke lejuar identifikimin e zonave të caktuara për akuakulturë në det dhe në tokë, përfshirë vlerësimet e përgjithshme për kapacitetin mbajtës mjedisor. Ngritja e një sistemi efektiv dhe transparent të lejeve dhe licencave për akuakulturën, i cili mbron interesat e investitorëve dhe nxit përcaktimin e një hapësire racionale dhe të qëndrueshme për akuakulturë.
	Një industri akuakulture e shumëllojshme, teknikisht kompetente dhe konkurruese ndërkombëtarisht, e cila funksionon brenda vendit dhe kontribuon në prodhimin evropian të produkteve të detit.	Adresimi i problemeve kryesore në konkurrueshmërinë e akuakulturës në Shqipëri përmes zhvillimit strategjik të prodhimeve ujore dhe disponibilitetit të rasave të peshqve. Përmirësimi i shumëllojshmërisë, vlerës dhe cilësisë së produkteve të akuakulturës shqiptare, që reflekton nivelin dhe llojet e ndryshme të akuakulturës në Shqipëri Bashkëpunimi me partnerë të huaj me eksperiencë për të prezantuar teknologji dhe aftësi të reja në akuakulturën shqiptare
Përpunimi, tregtimi dhe shpërndarja e	Përmirësimi dhe mbështetje e kushteve të higjienës dhe shëndetit të publikut	Institucionale – Forcimi i bashkëpunimit me Autoritetin Kompetent të Ushqimit
	Rritja e transparencës së tregut dhe forcimi i menaxhimit të tregut	Institucionale /Administrative – Projekt pilot për krijimin e një Organizate Prochuesish të peshkimit, funksionale dhe të njohur ligjorisht Administrative/Investime – Ngritja e një tregu funksional të shitjes me shumicë të peshkut dhe e një sistemi funksional të informacionit mbi tregun Mbështetje tregtimi për sektorin e peshkimit artizanal



Kuadri ligjor, administrativ dhe institucional

(Vlerat në 000 lekë)

Objektiva Specifike e Zhvillimit #1	Gjendja aktuale [nga raporti i vlerësimit]	Synimi [në 2022]
Forcimi i kapacitetit institucional të MBZHRAU për të administruar me efektivitet sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.	Drejtori jo-funksionale e peshkimit Pikëpyetje për rolin e DSHPA Inspektorat peshkimi jo-funksional	Drejtori e Peshkimit funksionale (që ekziston prej 2017) dhe të gjitha zyrat lokale kanë buxhet dhe personel të mjaftueshëm operacional dhe një plan të ZHBNJ
Masa 1.1: Krijimi i DP të Peshkimit, plotësisht funksionale, brenda MBZHRAU		
Aktivitetet	1.1.1 Miratimi nga MBZHRAU i strukturës së Drejtorisë së Peshkimit dhe rekrutimi i stafit në Drejtorinë e Peshkimit 1.1.2 Ristrukturimi me personelin përkatës (monitoruesit aktuale) i Inspektoriatit të Peshkimit brenda DP të Peshkimit 1.1.3 Miratimi i buxhetit të mjaftueshëm për Drejtorinë e Peshkimit 1.1.4 Vlerësim i kapacitetit të Drejtorisë së Peshkimit pasuar nga zbatimi i një plani zhvillimi / plani të ZHBNJ	
Indikatorët	1. Organograma e Drejtorisë së Peshkimit, numri i personelit të rekrutuar dhe miratimi i përkrahimit të punës për secilin punonjës (deri në fund të vitit 2016) 2. Përfundimi i raportit të vlerësimit të kapacitetit dhe adoptimi i rekomandimeve (mesi i vitit 2017 e më tej) 3. Miratimi dhe zbatimi i planit të ZHBNJ për Drejtorinë e Peshkimit (mesi i vitit 2017) 4. Buxheti vjetor i Drejtorisë së Peshkimit është i disponueshëm publikisht (Janar 2017 e më tej) dhe në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare 5. Përcaktimi i aktiviteteve administrative të peshkimit dhe integrimi i tyre në planin e punës së MBZHRAU (Janar 2017 e më tej) 6. Numri dhe vendndodhja e inspektorëve të peshkimit	
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: MBZHRAU	Të tjerë: Keshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Komitetet Këshillimore, QNOD, Inspektorati i Peshkimit
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme	Asistencë Teknike që propozohet:
	Asistencë për Politikë & Planifikimin (AT – FAO)	Specialist i Politikave & Planifikimit të Peshkimit – 2 vite (24 muaj për person, p/m)
	Vlerësim kapaciteti (AT)	Vlerësim i kapacitetit - 2 p/m
	Zbatimi i planit të BNJ (AT vendase + buxhet për trajnim)	Zbatimi i planit të BNJ përshin 2 p/m AT të huaj dhe 3 p/m AT vendase
	Total	90 000
		Lidhet me të gjitha Masat
Masa 1.2: Krijimi i një SIMP plotësisht funksional dhe forcimi i njesive të Inspektoriatit në portet e peshkimit		
Aktivitetet	1.2.1 Regjister funksional i anijeve, ditar udhëtimi dhe monitorim elektronik, certifikim i prodhimit, përdorimi i sistemeve të të dhënave për tregun me qëllim forcimin e kontrollit mbi peshkimin (Administrative & Investime) 1.2.2 Punime të vogla dhe pajisje për zyrat e porteve 1.2.3 Sistem funksional i gjurmimit të zënive, në përputhje me legjislacionin e BE 1.2.4 Hartimi i Procedurave Standarde Operacionale, PSO	
Indikatorët	1. Regjistrimet vjetore të QNOD (nga 2017) 2. Investime në pajisjet dhe programe IT (nga buxheti i shtetit dhe/ose komuniteti i donatorëve gjatë 2017) 3. Realizimi i disa kontratave të punimeve të vogla, deri në mesin e 2018	

	4. Numri i kurseve të trajnimit për SIMP 5. Dokumentacioni i PSO i përfunduar dhe në përdorim deri në fillim të 2018 6. Përdorimi i të dhënave për të orientuar procesin e vendim-marrjes prej menaxherëve të peshkimit (hartimin e rregulloreve etj.)	
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: MBZHRAU, Drejtoria e Peshkimit	Të tjerë: QNOD, Inspektorati i Peshkimit
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme	Asistencë Teknike që propozohet:
	Hartimi i PSO (AT)	Hartimi i PSO – 1.5 p/m (i huaj)
	Buxheti për trajnim (i përfaqësuar)	Hartimi i SIMP – 2 p/m (i huaj) dhe 2 p/m (vendase)
	Punime të vogla (zyrat në katër portet e peshkimit)	Lidhet me Masat 4.3 dhe 7.1
	Prokurimi i pajisjeve dhe hartimi i programeve kompjuterike (AT për krijimin e SIMP + buxhet për pajisje)	
	Total	30 000

Objektiva specifike e zhvillimit #2	Gjendja aktuale [nga raporti i vlerësimit]	Synimi [në 2022]
Ngritja e një sistemi transparent, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të bashkëmenaxhimit mes Geverisë, OMP-ve dhe palëve të tjera të interesuara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe PPSH.	Sistem jo-funksional i OMP-ve S'ka bashkëmenaxhim në peshkimin detar Bashkëmenaxhim i kufizuar i peshkimit në liqene dhe laguna	Ngritja e një sistemi funksional, përfaqësues dhe i qëndrueshëm i bashkëmenaxhimit, ku institucionet funksionale kombëtare sigurojnë mbështetje sektoriale dhe kontroll.
Masa 2.1: Zhvillimi i kapacitetit të strukturave të bashkëmenaxhimit të peshkimit (OMP-të)		
Aktivitetet	2.1.1 Hartimi i një Memorandumi Mirëkuptimi (MM) mes MBZHRAU dhe OMP-ve për zbatimin e planit strategjik kombëtar dhe planeve të menaxhimit të peshkimit 2.1.2 Analize e opsionit për taksat koncesionare të OMP-ve dhe rishikim të modelit të statutit të OMP-ve 2.1.3 Krijimi i Federatës Kombëtare të OMP-ve (organ përfaqësues për OMP-të) 2.1.4 Analizë funksionale e strukturës së OMP-ve dhe hartimi i një plani për rritjen e kapaciteteve 2.1.5 Trajnimi i anëtarëve të OMP-ve (zbatimi i planit të rritjes së kapaciteteve) 2.1.6 Krijimi i mekanizmave të zgjidhjes së konflikteve për OMP-të 2.1.7 Emërimi dhe trajnimi i monitoruesve, inspektorëve të peshkimit	
Indikatorët	<ul style="list-style-type: none"> MM i firmosur (mes OMP-ve dhe MBZHRAU) Numri dhe anëtarësia e OMP-ve aktive Anëtarësia e Federatës Kombëtare të OMP-ve dhe protokollet e takimeve Regjistrimet e takimeve (në nivel kombëtar dhe lokal) Numri i planeve të biznesit për OMP-të 	
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: MBZHRAU, Drejtoria e Peshkimit dhe Kryetari/Asambleja e OMP-ve	Të tjerë: Anëtarësia e OMP-së, pushteti lokal dhe inspektorati i peshkimit



Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme:		Asistenca Teknike që propozohet: Analiza funksionale, ngritja e kapaciteteve dhe plan biznesi – 3 p/m (i huaj) dhe 2 p/m (vendas) Lidhet me Masën 6.2
	Buxheti për trajnim (i përafert)	14 000	
	Financim për Federatën e OMP-ve (5 vjet)	14 000	
	Plan biznesi dhe ngritja e kapaciteteve (AT)	12 000	
	Total	40 000	
Masa 2.2: Këshillim funksional nga Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (KKQPA) dhe Komisioni për Koordinimin e Kërkimit Shkencor dhe Teknologjik (KKKSHT)			
Aktivitetet	2.2.1 Krijimi dhe takime çdo 6 muaj të KKQPA 2.2.2 Krijimi dhe takime çdo 5 muaj të KKKSHT 2.2.3 Trajnimi i anëtarëve të të dyja komisioneve		
Indikatorët	<ul style="list-style-type: none"> Statutet e komisioneve (dokumentacion ligjor) Protokollet e takimeve Regjistrimi i trajnimeve dhe raportet e udhëtimeve studimore 		
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: MBZHRAUA, Drejtorja e Peshkimit		Të tjerë: përfaqësuesit e industrisë dhe ata akademikë
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme:		Asistenca Teknike që propozohet: Trajnim – 1.0 p/m (i huaj) Lidhet me Masat 4.4, 7.1, 13.1 & 14.1
	Shpenzimet e takimeve të KKQPA (5 vjet)	1 500	
	Shpenzimet e takimeve të KKKSHT (5 vjet)	1 500	
	Total	3 000	

Objektiva specifike e zhvillimit #3	Gjendja aktuale [nga raporti i vlerësimit]	Synimi [në 2022]
Përafrimi i menaxhimit, kontrollit, tregimit, politikës strukturore, procedurës së planifikimit dhe legjislacionit të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës për komponentët përkatës të <i>Acquis</i> së Peshkimit.	Përafrim pjesor i legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën PPSH nuk është përgatitur Nuk ka politikë strukturore apo plan të sektorit Nuk ka PKV kundër IUU Kapacitet i kufizuar brenda MBZHRAUA për kontrollin e peshkimit	PPSH është hartuar dhe ka filluar të zbatohet Plani strategjik kombëtar shumëvjeçar për zhvillimin e peshkimit dhe akuakulturës në Shqipëri (2015 – 2020) është hartuar dhe zbatuar me sukses. Janë kryer vlerësime të ndërmjetme dhe përfundimtare Në fund të vitit 2020 është përgatitur dhe miratuar plani pasardhës (2022 – 2028).
Masa 3.1: Forcimi i procedurave administrative të PPP dhe i legjislacionit (Projekti i Binjakëzimit)		
Aktivitetet	3.1.1 Hartimi i një strategjie përafrimi për legjislacionin ekzistues 3.1.2 Krijimi i një njësie ligjore për peshkimin brenda MBZHRAUA 3.1.3 Përditësimi i Ligjit për Peshkimin (para fundit të 2017) 3.1.4 Përgatitja e PPSH (deri në fund të 2017) 3.1.5 Trajnimi për procedurat administrative të PPP, me fokus politikën strukturore dhe menaxhimin e peshkimit (Projekti i Binjakëzimit)	

Indikatorët	Binjakëzimit)		Të tjerë: Komitetet Këshillimore, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit Evropian
	1. Legjislacioni i adoptuar		
	2. Dokumentet e politikës janë adoptuar dhe zbatuar		
	3. Regjistrimet e njësive juridike për procesin e përafërimit të legjislacionit për peshkimin		
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: MBZHRAUA, Drejtorja e Peshkimit dhe partnerët e Binjakëzimit (duhen identifikuar vendet anëtare të BE)		
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme:		Asistenca Teknike që propozohet: Hartimi i dokumenteve ligjore – 2 p/m (i huaj) dhe 4 p/m (vendas) Projekti i Binjakëzimit – 2 keshilltare, secili për 2 vjet plus 12 muaj AT afatshkurterë e paspecifikuar (AT total = 60 p/m) Lidhet me Masën 1.1
	AT ligjore (përfshirë në Projektin e Binjakëzimit?)	10 000	
	Kostot e njësive juridike (trajnimi për 5 vjet)	4 000	
	Projekti i Binjakëzimit (2 vjet)	246 000	
	Total	260 000	
Masa 3.2: Hartimi dhe zbatimi i një Programi Operacional (PO)			
Aktivitetet	3.2.1 Hartimi i planit të sektorit (bëra operacionale e Strategjisë së Peshkimit) (deri në mes 2017) 3.2.2 Rishikim afatmesëm (mesi i vitit 2019) 3.2.3 Hartimi i një plani pasues për sektorin 2022 – 2028 (i miratuar deri në fund të 2021)		
Indikatorët	<ol style="list-style-type: none"> Miratimi i Strategjisë së Peshkimit dhe përgatitja e PPSH Plane kërkimore dhe për trajnim Planet vjetore të zbatimit dhe aktivitetet janë integruar në planin e punës së MBZHRAUA (Janar 2017 e më tej) Janë bërë vlerësimet afatmesme dhe përfundimtare dhe rekomandimet janë integruar zyrtarisht në strategjinë shumëvjeçare aktuale (2017 – 2022) dhe pasuese (2022 – 2028) (respektivisht dhjetor 2019 dhe dhjetor 2021) 		
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: MBZHRAUA, Drejtorja e Peshkimit		Të tjerë: Komitetet Këshillimore, përfaqësuesit e industrisë, përfaqësuesit akademikë, etj.
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme:		Asistenca Teknike që propozohet: Asistenca për planifikimin është përfshirë në masat e tjera Asistenca për vlerësimin afatmesëm dhe përfundimtar – 2 p/m (i huaj) dhe 2 p/m (vendas) Lidhet me Masën 11.1
	Koha e harxhuar dhe shpenzimet e Grupit të Punës	3 500	
	Vlerësimet	8 000	
	Planifikimi dhe raportimi vjetor i punës	3 500	
	Total	16 000	

Peshkimi detar dhe bregdetar

(vlerat në 000 lekë)

Objektiva Specifike e Zhvillimit #4	Gjendja aktuale [nga raporti i vlerësimit]	Synimi [në 2022]
Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve tregtare detare nëpërmjet një kontrolli efektiv dhe mbështetjeje tek shkenca e sakte.	Ligji i peshkimit është hartuar por zbatohet pak; nuk ka plan të menaxhimit të peshkimit; MKV është e kufizuar. Shumica e rezervave të vlerësuara në	Planet e Menaxhimit janë hartuar për rezervat kryesore komerciale dhe po drejtojnë në mënyrë aktive kontrollin dhe zhvillimin e sektorit. Është ngritur një sistem efektiv i MKV, në përputhje me rregulloret e



	GSA 18 janë të MB i-peshkuara. Ka pak apo aspak vlerësim të rezervës dhe mbledhje të të dhënave.	BE për peshkimin IUU. Është bërë vlerësimi në nivel rajonal (GSA 18) apo kombëtar i 10 specieve kryesore tregtare. Kuari për mbledhjen e të dhënave jep rregullisht informacion të mjaftueshëm për orientimin e menaxhimit të sektorit.
Masa 4.1: Hartimi dhe zbatim i Planit të Menaxhimit të Rezervave		
Aktivitetet	4 4.1 4.1.1 Takime tre-mujore të Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën 4.1.2 Ngritja e kapaciteteve brenda Drejtorisë së Peshkimit për menaxhimin e rezervave 4.1.3 Identifikimi i burimeve kyç për t'u përfshirë në planin e menaxhimit 4.1.4 Hartimi i Planit të Menaxhimit të Rezervave	
Indikatorët	1. Takime të rregullta të KKQPA (nga tremujori i tretë i 2017 dhe në vazhdim) – lidhet me Masën 2.2 2. Trajnimi i personelit të Drejtorisë së Peshkimit për menaxhimin e rezervave 3. Plani i Menaxhimit të Rezervave është hartuar dhe zbatuar (2016 deri në 2022)	
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: Drejtoria e Peshkimit, Departamenti i Zënies së Peshkut Një zyrtar ekzekutiv me kohë të pjesshme (sekretariati i KKQPA dhe AT e menaxhimit të projektit)	Të tjerë: Gjithë sektori, përfshirë Komitetet Këshillimore, përfaqësuesit e industrisë, përfaqësuesit akademikë, etj.
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme: mbështetje me AT (menaxhimi i rezervave) 12 000 Total 12 000	Asistenca Teknike që propozohet: Trajnimi mbi Planifikimin e Menaxhimit të Rezervave dhe hartimin e Planeve të Menaxhimit të Rezervave (3 p/m i huaj, 3 p/m vendas), drejtuar nga KKQPA. Lidhet me Masat 2.2 & 8.1
Masa 4.2: Ngritja e sistemit të Monitorim, Kontroll, Vëzhgimit (MKV), për të detyruar zbatimin e rregullore të peshkimit		
Aktivitetet	4.2 4.3 4.2.1 Krijimi i protokolleve të MKV për të integruar detyrimin për zbatimin e ligjit të peshkimit brenda aktiviteteve të QNOD 4.2.2 Trajnimi i inspektoratit të peshkimit për protokollin e reja 4.2.3 Kryerja e inspektimeve në port dhe në det	
Indikatorët	1. Memorandume Marrëveshesh mes partnerëve të QNOD mbi planin e MKV në peshkim (2017) 2. Seancat e trajnimit të Inspektoratit të Peshkimit kanë përfunduar (2017) 3. Raportet vjetore të performancës së Inspektoriatit të Peshkimit (2018 e më tej)	
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: Drejtoria e Peshkimit, Departamenti i Zënies së Peshkut Punonjës teknik (me kohë të pjesshme, 3 muaj / vit)	Të tjerë: QNOD
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme: Mbështetje me AT 8 000	Asistenca Teknike që propozohet: Trajnimi i Inspektoratit të Peshkimit për 50 vete (kryeinspektori, 22

	Total	8 000	inspektorët dhe policia kufitare) 69 për person + 1.5 p/m i huaj. Lidhet me Masën 9.1
Masa 4.3: Kuadri i mbledhjes së të dhënave për peshkimin			
Aktivitetet	4.3.1 Ngritja e kuadrit kombëtar të mbledhjes së të dhënave 4.3.2 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave		
Indikatorët	1. Kuadri për mbledhjen e të dhënave është ngritur (2017) 2. Personeli rajonal ka marrë trajnimin mbi mbledhjen e të dhënave (2017) 3. Raport vjetor statistikor duke përdorur të dhënat nga DGJP (2017)		
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: Drejtoria e Peshkimit, Sektori i Zënies së Peshkut 1 statisticien me kohë të plotë (mbledhje të dhënash dhe raportim) Personel rajonal (25% e kohës mbledhje të dhënash dhe raportim)		Të tjerë: Institucione kërkimore shkencore, publike/private për mbledhjen e të dhënave
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme: mbështetje me AT (trajnimi i personelit rajonal) 6 000 Total 6 000		Asistenca Teknike që propozohet: Trajnimi i personelit rajonal për mbledhjen e të dhënave – 2 p/m (i huaj) Lidhet me Masat 1.2, 7.1 dhe 12.3
Masa 4.4: Ngritja e kapacitetit të shkencës së peshkimit			
Aktivitetet	4.4 4.4.1 Hartimi i Planit të Kërkimit për Peshkimin që të përfshihet në Planin e Menaxhimit të Rezervës 4.4.2 Rritja e kapacitetit kërkimor të peshkimit, për të kontribuar në kërkesat rajonale dhe kombëtare të shkencës së peshkimit. 4.4.3 Rishikimi i kërkesave të shkencës së peshkimit dhe ngritja e kapaciteteve		
Indikatorët	1. Plani kërkimor është përfshirë në Planin e Menaxhimit të Rezervës (2017) 2. Raporti mbi kapacitetin e shkencës së peshkimit dhe vlerësimin e nevojave (2017) 3. Pjesëmarrje e plotë në aktivitetet rajonale të menaxhimit të peshkimit (GFCM, ICCAT) (2017) 4. Raportim vjetor Mbi gjendjen e rezervës duke përdorur të dhënat e vëzhgimeve rajonale dhe kombëtare (2018)		
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: Drejtoria e Peshkimit, Sektori i Zënies së Peshkut 1 punonjës me kohë të pjesshme (sekretariati i Komitetit Shkencor) Shkencëtarë Peshkimi (për speciet kyç tregtare)		Të tjerë: Institucione kërkimore shkencore, publike/private për mbledhjen e të dhënave
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme: Mbështetje me AT (rishikim i kapacitetit dhe nevojave) 4 000 Total 4 000		Asistenca Teknike që propozohet: Rishikimi i Kapacitetit të Shkencës së Peshkimit (1 p/m i huaj, 1 p/m vendas) Lidhet me Masat 2.2, 4.1, 7.2 & 14.1
Objektiva Specifike e Zhvillimit #5	Gjendja aktuale [nga raporti i vlerësimit]	Synimi [në 2022]	
Një flotë detare e suksesshme dhe	Flota është e vjetër (39 vjeçare), joaktive	Flota është në ekuilibër me mundësitë për peshkim, në drejtim të	



konkurruese	(56% e tratave fundore joaktive, 152 ditë peshkimi nga anijet aktive) dhe e mbajtur keq. Përfitim minimal, ndërsa disa sektorë (tratrat e vogla) janë me humbje. Ka pak menaxhim aktiv të infrastrukturës së porteve dhe pak struktura të degraduara (s'ka shkallë riparimi), duke bërë që anijet të përdorin strukturat në portet e huaja.	numrit dhe metodave të peshkimit. Anijet janë modernizuar për të përmirësuar efektivitetin e konsumit të naftës, reduktuar ndikimin në mjedis dhe përmirësuar cilësinë e prodhimit dhe standardet e sigurisë. Performanca ekonomike e flotës aktive është përmirësuar dhe është e mjaftueshme për të sjellë investime të reja në flotë. Infrastruktura e përmirësuar e porteve rezultojnë në një sasi më të madhe prodhimi që shkarkohet në portet shqiptare dhe me cilësi më të lartë.
Masa 5.1: Ekuilibrimi i kapacitetit të flotës në linjë me burimet peshkore		
Aktivitetet	5.1.1 Rishikimi i kapacitetit dhe gjallërisë së flotës, për çdo segment të saj (nën drejtimin e KKQPA) 5.1.2 Amendimi i licencimit të flotës së peshkimit detar, në kuadër të gjetjeve nga rishikimi	
Indikatorët	1. Raport Mbi kapacitetin e flotës dhe potencialin për diversifikim (2017)	
Përgjegjësit partnerët	Kryesorë: Drejtoria e Peshkimit, Sektori i Zënies së Peshkut	Të tjerë: Gjithë sektori, përfshirë Komitetet Këshillimore, përfaqësuesit e industrisë, përfaqësuesit akademikë, etj.
Burimet	Vlerësimi për kostot e stafit dhe kostot e përgjithshme: mbështetje me AT 8 000 Total 8 000	Asistenca Teknike që propozohet: Rishikimi i kapacitetit të flotës dhe potencialit për diversifikim (dhe hartimi i kriterëve të financimit të Skemës së Modernizimit të Flotës) - 2 p/m i huaj + 2 p/m vendas Lidhet me Masën 8.2
Masa 5.2: Modernizimi i flotës		
Aktivitetet	5.2.1 Modernizimi i flotës & dhe skema e diversifikimit (me kriterë të repta financimi – të hapura për anijet aktive të ligjshme, dhe që nuk rritin kapacitetin)	
Indikatorët	1. Numri i projekteve të financuara të modernizimit 2. Flota e modernizuar e krahasuar me gjendjen në 2016 (nga 2021, vlerësimi bazohet në statistikat që dalin nga Mbledhja e të dhënave) 3. Një pjesë më e vogël e flotës aktive që peshkon me trata fundore (nga 2021, vlerësimi bazohet në statistikat që dalin nga Mbledhja e të dhënave) 4. Performancë e përmirësuar ekonomike (përfshirë reduktimin e kostove të karburantit) (nga 2021, vlerësimi bazohet në statistikat që dalin nga Mbledhja e të dhënave)	
